# EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XIX, nr. 5671
E mërkurë, 9 janar 2019
çmimi 0.40 €


## Haradinaj zotohet se do të merren parasysh kërkesat e SBAShK-ut

FAQE 7




Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"



AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de




FLET PËR "EPOKËN E RE", BAJRUSH XHEMAJLI FAQE 4-5

# Zgjedhjet e brendshme po e bashkojnë dhe fuqizojnë PDK-në

Nënkryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) për çështje organizative, Bajrush Xhemajli, është shprehur i bindur se zgjedhjet e brendshme do ta fuqizojnë dhe konsolidojnë këtë parti. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se ky proces po e bashkon PDK-në. Sipas tij, kjo po ndodh sepse ky proces po zhvillohet në mënyrë demokratike dhe pa hatërmbetje. Ai ka treguar se në këtë proces është duke ndodhur edhe kthimi i atyre që dikur e patën braktisur PDK-së dhe, po sipas tij, ka ardhje të personaliteteve nga partitë e tjera politike

# Mogherini kërkon nga delegacioni shtetëror i Kosovës heqjen e taksës



Përfaqësuesja e lartë e Bashkimit Evropian për Politikë të Jashtme dhe të Sigurisë, Federica Mogherini, ka pritur të martën në takim delegacionin shtetëror të Kosovës për dialog me Serbinë. Me këtë rast ajo ka thënë se është e domosdoshme arritja e marrëveshjes për normalizimin e plotë të marrëdhënieve Kosovë - Serbi. Mogherini u ka kërkuar autoriteteve të Kosovës ta shfuqizojnë taksën doganore ndaj produkteve serbe. Bashkëkryesuesi i ekipit negociator, Fatmir Limaj, ka shprehur gatishmërinë për të dialoguar, por ka bërë me dije se taksa nuk do të hiqet FAQE 3

## Qytetarët të shqetësuar nga grabitjet e armatosura

FAQE 7



Kohët e fundit janë shpeshtuar rastet e grabitjeve të armatosura në Kosovë, duke u bërë kështu dukuri mjaft shqetësuese. Cak i grabitjeve kanë qenë shtëpitë private, dyqanet e bizneseve si dhe bankat

## AKTUALE

### ASIMETRITË MIDIS DIALOGUT TË BRENDSHËM DHE DIALOGUT ME FQINJËT F. 10



Shkruan: Lisen BASHKURTI

### HOTI: PARAQITJA E EKIPIT NEGOCIATOR NË BRUKSEL, E DOBËT DHE PA LEGJITIMITET F. 3

### KURTI TAKON AMBASADORIN E ZVICRËS, IA PREZANTON QËNDRIMIN PËR DIALOGUN F. 7

## EKONOMI



### SHALA PRET NË TAKIM HARADINAJN, 2019-TA VIT I INVESTIMEVE STRATEGJIKE F. 9

### ATK-ja: AFATI PËR REGJISTRIMIN E MALLRAVE NË STOQE, DERI MË 10 JANAR F. 9

## KULTURË

INTERVISTË ME AKADEMIK MEHMET KRAJËN (4)

### SHKATËRRIMI INSTITUCIONAL KULTUROR NUK NDALET F. 16-17



## SPORT

### SELIMI: DUHET TË BESOJMË NË TRAJNERËT VENDORË F. 20


RENOVA PUTZ
Maqedoni Xhepçisht –Tetovë Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009 +389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM PROJEKTIM SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan , Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

# Zaevi pranon disa prej kërkesave të opozitës shqiptare

Pasi që opozita shqiptare mbështetjen e ndryshimeve kushtetuese e ka kushtëzuar me pranimin e amendamenteve të tyre për forcimin e statusit juridik të shqiptarëve në Kushtetutë, kryeministri i Maqedonisë, Zoran Zaev, i ka pranuar disa prej kërkesave të tyre



SHKUP, 8 JANAR - Kryeministri i Maqedonisë, Zoran Zaev, ka pranuar disa prej kërkesave të opozitës shqiptare, e cila mbështetjen e ndryshimeve kushtetuese e ka kushtëzuar me pranimin e amendamenteve të tyre për forcimin e statusit juridik të shqiptarëve në Kushtetutë.
Pas takimit me kryetarin e Aleancës për Shqiptarët, Zijadin Sela, kreu i Qeverisë tha se është pranuar ndryshimi i preambulës me atë që në nuk do të ketë "qytetarë të dyfishtë". Përkufizimi i ri i preambulës Maqedoninë e përkufizon si "shtet të qytetarëve të Maqedonisë, popullit maqedonas si dhe pjesëve të popullit shqiptar, turq, rom, vllah, serb, rom, boshnjak".
Kryeministri Zaev tha se është pranuar edhe kërkesa tjetër lidhur me kujdesin e shtetit ndaj diasporës me të cilën përmendej vetëm kombi maqedonas, ndërsa tani në të thuhet se "shteti do të kujdeset ndaj popullit maqedonas dhe bashkësive të tjera etnike që jetojnë këtu".
Kreu i Aleancës për Shqiptarët, Zijadin Sela, tha se për çështjen e gjuhës nuk është arritur marrëveshje, por se "nuk do të heqë dorë nga beteja që shqipja të mos përkufizohet si gjuhë që e flasin 20 për qind e popullatës, por si gjuhë shqipe".
Ndërkohë, ende mbetet e paqartë nëse është pranuar ose jo kërkesa e Lëvizjes Besa lidhur me dokumentet personale. Kjo parti kërkon që në pasaporta dhe letërnjoftimet në grafën e shtetësisë të mos shënohet "maqedonas/qytetar i Maqedonisë së Veriut", por vetëm pjesa e dytë, apo të shënohet edhe përkatësia etnike e shqiptarëve.
Kryeministri Zoran Zaev, paraprakisht kishte thënë se do të bënte gjithçka për të siguruar votat edhe të këtyre partive. "Deri në momentin e fundit do të bëj gjithçka që të sigurojmë dy të tretat e votave dhe këtë do t'ia kumtojmë opinionit në momentin e votimit dhe së bashku do të ndajmë kënaqësinë nga ajo që kemi arritur, apo do të bartim përgjegjësinë. Por, unë jam optimist para së gjithash për përgjegjësinë që e bartin të gjithë deputetët për këtë proces që kemi shansin ta përmbyllim me sukses", ka deklaruar kryeministri Zaev.
Nga Bashkimi Demokratik për Integrim që është pjesë e Qeverisë kanë kritikuar qëndrimin e partive opozitare shqiptare duke kërkuar që të venë në rrezik zgjidhjen e kontestit të emrit që zhbllokon procesin eurointegrues.
"Shërbimin më të keq që mund t'ua bëni shqiptarëve në këtë moment është që të prezantoni se shqiptarët janë ata që e pengojnë procesin e anëtarësimit të vendit në NATO. Nuk ka interes më të rëndësishëm etnik për shqiptarët sesa anëtarësimi i Maqedonisë në NATO. Ky është interes i të gjithë shqiptarëve në rajon", ka deklaruar Bujar Osmani, zëvendëskryeministër për Çështje Evropiane.
Por, kreu i Qeverisë po përballet edhe me rrezikun e humbjes së votave nga tetë deputetët e përjashtuar të VMRO-së. Ata kanë bërë të ditur se vota e tyre mund të jetë kundër ndryshimeve nëse pranohen kërkesat e opozitës shqiptare, pasi sipas tyre heqja dorë nga përcaktimet që forcojnë identitetin maqedonas, rrezikojnë zbatimin e Marrëveshjes me Greqinë, të arritur më 17 qershor të vitit të kaluar, që parasheh emrin e ri të shtetit, Maqedonia e Veriut.
Njohësit e çështjeve politike thonë se vendin ndodhet para një sfide të re para amendamenteve të paraqitura nga partitë opozitare shqiptare.
Analisti, Petar Arsovski beson se procesi mund të shpëtohet në gjetjen e një kompromisi të mundshëm por jo edhe në lëshime që do t'i humbnin esencën marrëveshjes apo që do të rrezikonin votat e deputetëve të përjashtuar të VMRO-së që tani veprojnë si të pavarur. "Nuk besoj se Zaevi do të bëjë lëshime për diçka për të cilën është marr vesh me palën greke. Këtë nuk besoj se edhe Lëvizja Besa mund ta kërkojë, e kryeministri t'ia japë. Mendoj se kompromisi i vetëm që mund të bëhet është që të ketë lehtësime gjatë zbatimit të Marrëveshjes së Prespës lidhur me ndonjë kërkesë të partive shqiptare", thotë Arsovski.
Që të jetë e plotfuqishme, Marrëveshja për emrin duhet të ratifikohet edhe nga Parlamenti i Greqisë, por vetëm pasi më parë të jetë zbatuar tërësisht nga Maqedonia.

# Hasani: Lugina e Preshevës t'i bashkëngjitet Kosovës



PRESHEVË, 8 JANAR - Përfaqësuesi i Partisë për Veprim Demokratik në Parlamentin e Serbisë, Fatmir Hasani, tha se pret që në bisedimet midis Prishtinës dhe Beogradit të diskutohet edhe për Luginën e Preshevës, që përfshinë komunat Bujanoc, Preshevë dhe Medvegjë. Hasani tha se pret që zgjidhja të jetë në atë mënyrë që këto komuna t'i bashkëngjiten Kosovës.
Ai i tha agjencisë Beta se kërkesa zyrtare për përfshirjen e Luginës së Preshevës në negociatat ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës në Bruksel është shkruar në një letër, të cilën përfaqësuesit e Këshillit Kombëtar të Shqiptarëve dhe kryetari i Bujanocit, Shaip Kamberi i kanë dërguar Përfaqësueses së Lartë të BE-së, Federica Mogherini dhe Qeverisë së Kosovës. "Ne besojmë se do të jemi të përfaqësuar në negociata", ka thënë Hasani. Ai ka thënë se "kërkesa jonë lidhet vetëm me bashkëngjitjen në Kosovë, pasi mendojmë se është e mundur të arrihet një marrëveshje e pranueshme që sjell paqe të qëndrueshme midis Prishtinës dhe Beogradit".

## Shqipëria nis lobimin për hapjen e negociatave



TIRANË, 8 JANAR - Hapja e negociatave është objektiv për Shqipërinë gjatë këtij viti. Ndërsa Rumania mban presidencën e radhës së Bashkimit Evropian nga 1 janari 2019 deri më 30 qershor 2019, kryetari i Kuvendit, Gramoz Ruçi, ka filluar lobimin me Presidencën rumune për çeljen e negociatave. Ruçi i ka dërguar një letër presidentit të Dhomës rumune, Dragnea dhe të Senatit rumun, Tariceanu. Në letrën e tij Ruçi thekson se "Shqipëria beson fort te suksesi i Presidencës rumune". "Evropa e zgjeruar, Evropë më e fortë dhe konvergjente", shprehet Ruçi.

EPOKA E RE
Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

Delegacioni shtetëror i Kosovës për dialog me Serbinë është pritur në takim nga përfaqësuesja e lartë e Bashkimit Evropian, Federica Mogherini

# Mogherini kërkon nga delegacioni shtetëror i Kosovës heqjen e taksës

Përfaqësuesja e lartë e Bashkimit Evropian për Politikë të Jashtme dhe të Sigurisë, Federica Mogherini, ka pritur të martën në takim delegacionin shtetëror të Kosovës për dialog me Serbinë. Me këtë rast ajo ka thënë se është e domosdoshme arritja e marrëveshjes për normalizimin e plotë të marrëdhënieve Kosovë - Serbi. Mogherini u ka kërkuar autoriteteve të Kosovës ta shfuqizojnë taksën doganore ndaj produkteve serbe. Bashkëkryesuesi i ekipit negociator, Fatmir Limaj, ka shprehur gatishmërinë për të dialoguar, por ka bërë me dije se taksa nuk do të hiqet



EPOKA E RE Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 8 JANAR - Delegacioni shtetëror i Kosovës për dialog me Serbinë të martën ka zhvilluar takimin e parë me përfaqësuesen e lartë të Bashkimit Evropian, Federica Mogherini. Në këtë takim Mogherini ka thënë se është e domosdoshme arritja e marrëveshjes për normalizimin e plotë të marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. "Arritja e marrëveshjes gjithëpërfshirëse, ligjërisht obliguese për normalizimin e plotë të marrëdhënieve ndërmjet Prishtinës dhe Beogradit në kuadër të dialogut, kërkon një klimë që kontribuon në marrëdhënie të mira fqinjësore, ku marrëveshjet e arritura më herët duhet të respektohen dhe zbatohen dhe veprimet e deklaratat, që nuk janë në interes të përgjithshëm dhe objektivat strategjike të rajonit, duhet të shmangen", është thënë në deklaratën e lëshuar nga zyra e Mogherinit.
Me këtë rast Mogherini u ka kërkuar autoriteteve të Kosovës që ta shfuqizojnë taksën doganore ndaj produkteve të Serbisë. "Ky takim ishte një mundësi për të biseduar me përfaqësuesit e Kosovës lidhur me dialogun. Në këtë kontekst, Mogherini ka ritheksuar urgjencën për shfuqizimin e tarifës doganore të vendosur nga Qeveria e Kosovës", është theksuar më tutje në deklaratë. Ndërsa bashkëdrejtuesi i ekipit shtetëror të Kosovës, Fatmir Limaj, ka treguar se në këtë takim kanë prezantuar rolin e delegacionit dhe gatishmërinë për të diskutuar për temat e hapura ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, të cilat, sipas tij, do të çonin deri të një marrëveshje gjithëpërfshirëse me kushtin parësor njohjen reciproke.
Ai ka treguar se në këtë takim kanë diskutuar për liberalizimin e vizave, çështjen e të pagjeturve dhe taksën. "Ne kërkuam që të jepet një angazhim shtesë dhe Kosova ta marrë lajmin e shumëpritur dhe të merituar. Ishte një rast i mirë i prezantimit të Kosovës në dialog. E bëmë të qartë se Kosova ka ekip shtetëror që përfaqëson vendin tonë. Tani do ta shohim se si do të përcaktohet agjenda", është shprehur ai. Limaj ka thënë para gazetarëve se marrëveshja me Serbinë duhet të jetë marrëveshje gjithëpërfshirëse që në zemër e ka njohjen. Sipas Limajt, çështja e taksës përfundimisht hiqet në rast se Serbia e njeh Kosovën. "Ne e thamë aty se duhet të hiqen arsyet për të cilat ka ardhur taksa. Serbia duhet t'i pushojë të gjitha arsyet pse ne e kemi ngritur taksën. Ka shumë kushte që Serbia t'i plotësojë që të tërhiqet taksa. Me një marrëveshje gjithëpërfshirëse më nuk do të ketë nevojë për taksë", ka deklaruar Limaj.
Kurse bashkëkryesuesi tjetër i ekipit negociator, Shpend Ahmeti, ka thënë se është kërkuar që të punohet me një orar më të ngjeshur në gjysmën e parë të këtij viti për të parë nëse do të mund të arrihet një marrëveshje. "Sipas Mogherinit, për BE-në çdo marrëveshje që është e pranueshme për të dyja palët, marrëveshje e cila i përfaqëson vlerat e Bashkimit Evropian, është e pranueshme edhe për ta. Pra, nuk mund dhe nuk do të kemi shtete etnikisht të pastra, sepse ajo nuk është vlerë e BE-së. Nuk mund të kemi kufij që ndajnë etnitë në vija të tilla", ka theksuar Ahmeti, duke shtuar se ia kanë sqaruar Mogherinit që ekipi negociator nuk është në mbështetje të dikujt, por ka mandat nga Kuvendi.




## Veseli: Nuk do të lejojmë asnjë rezultat që dobëson integritetin e shtetit

Kryetari i Kuvendit të Kosovës dhe kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Kadri Veseli, ka mirëpritur takimin e delegacionit shtetëror të Kosovës me përfaqësuesen e lartë të Bashkimit Evropian, Federica Mogherini. Ai ka thënë se ky delegacion ka mandat të plotë legal dhe legjitim nga Kuvendi i Kosovës. "Kosova është e gatshme dhe e vendosur për dialog me Serbinë. Vendimet që do të merren do të jenë në respekt të plotë të shtetit të pavarur e sovran të Kosovës dhe në koordinim me partnerët tanë perëndimorë, si dhe të gjithë mbështetësit e shtetit tonë", ka shkruar Veseli në llogarinë e vet në "Facebook". Ai ka thënë se refuzimi i dialogut nuk është alternativë e as zgjidhje. "Kosova hyn në dialog me qëllime të qarta: njohje e shtetit të Kosovës nga ana e Serbisë dhe anëtarësim në OKB. Ne nuk do të lejojmë asnjë rezultat që dobëson integritetin e shtetit të Kosovës. Ne hyjmë në dialog për ta fuqizuar edhe më shumë shtetin e Kosovës dhe do t'ia arrijmë pa asnjë mëdyshje. Nuk kemi kohë për të humbur. Bashkimi për interes të shtetit duhet të ndodhë menjëherë. Është koha për të menduar për vendin, jo për interesat e tjera apo për kalkulime përfitimesh nga gabimet e pritura të të tjerëve", ka deklaruar Veseli. Ai ka thënë se puna të cilën e ka nisur delegacioni shtetëror i Kosovës do të jetë transparente në të gjitha fazat e saj, ndërkaq vendimi final do të legjitimohet me vullnetin e lirë të sovranit. "Për këtë ne do ta kalojmë shumë shpejt në Kuvendin e Kosovës ligjin për referendumin. Do të jenë vetë qytetarët e Kosovës që do ta thonë fjalën e fundit për rezultatet e procesit. Zëri i popullit është zëri i Zotit. Së pari Kosova", ka deklaruar Veseli.

## Hoti: Paraqitja e ekipit negociator në Bruksel, e dobët dhe pa legjitimitet

PRISHTINË, 8 JANAR - Shefi i grupit parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Avdullah Hoti, ka thënë se paraqitja e ekipit negociator në Bruksel ka qenë e dobët dhe pa legjitimitet. Ai ka theksuar se përfshirja e Partisë Socialdemokrate (PSD) në këtë ekip është vetëm sa për dekor dhe për ta maskuar mungesën e legjitimitetit të koalicionit PAN. "Paraqitja e Kosovës në Bruksel asnjëherë nuk ka qenë më e dobët, më jolegjitime dhe me premisa për të shkaktuar më shumë dëme. Ky ekip negociator, me përfshirjen e PSD-së, është thjesht dekor për ta maskuar mungesën e legjitimitetit të koalicionit PAN. Në këtë format si është, ky ekip nuk ka fuqi të marrë vendime apo të kundërshtoj dhe as të punoj unik. Rrjedhimisht, nuk mund t'i mbrojë interesat tona. Asnjëherë më parë nuk ka ndodhur që një delegacion i Kosovës të shkojë në Bruksel me qëllime kaq të paqarta dhe enigmatike sa ky ekip 'negociator' dekorues", ka shkruar Hoti në llogarinë e vet në "Facebook".

Flet për "Epokën e re", Bajrush Xhemajli

# Zgjedhjet e brendshme po e ba



## - Po ndodh kthimi i atyre që dikur e patën braktisur PDK-në

**Nënkryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) për çështje organizative, Bajrush Xhemajli, është shprehur i bindur se zgjedhjet e brendshme do ta fuqizojnë dhe konsolidojnë këtë parti. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se ky proces po e bashkon PDK-në. Sipas tij, kjo po ndodh sepse ky proces po zhvillohen në mënyrë demokratike dhe pa hatërmbetje. Ai ka treguar se në këtë proces është duke ndodhur edhe kthimi i atyre që dikur e patën braktisur PDK-së dhe, po sipas tij, ka ardhje të personaliteteve nga partitë e tjera politike**

EPOKA E RE Muhamet KOCI

PRISHTINË, 8 JANAR - Nënkryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) për çështje organizative, Bajrush Xhemajli, ka lavdëruar procesin e brendshme zgjedhor nëpër të cilin po kalon kjo parti. Ai është shprehur i bindur se ky proces PDK-në do ta konsolidojë dhe do ta nxjerrë më të fuqishme.

Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka treguar se gara në këto zgjedhje po ndodh përmes një procesi konkurrues dhe pa hatërmbetje. "Synimi ynë si parti është që të dalim shumë më të fuqishme nga ky proces zgjedhor. Në bazë të asaj që kam parë në terren, besoj shumë se do të dalim shumë më të fortë nga ky proces. Do të dalim më të fortë sepse në gjithë këtë proces konkurrues nëpër nëndegë deri më tani nuk ka pasur hatrime apo ndonjë përçarje. Pra, ky proces vetëm po na forcon dhe po na bashkon", ka thënë Xhemajli, i cili është edhe nënkryetar i komisionit për procesin zgjedhor në PDK.

Ai ka thënë se në këtë proces po ndodh edhe një trend i kthimit në PDK të atyre që më herët e kishin braktisur këtë subjekt politik. Sipas Xhemajlit, nuk mungojnë as ardhjet prej partive të tjera. "Besoj se tani është njëfarë trendi i kthimit të atyre që më herët e kanë lënë PDK-në për t'iu bashkuar partive të tjera. Për shembull, në Ferizaj më herët është kthyer Xhabir Morina, në Lipjan tani është kthyer doktori Fitim Selimi me shumë aktivistë të tjerë. Pra, në PDK nuk po kthehen vetëm individë, por edhe shtresa të rëndësishme të shoqërisë. Pastaj në Shtime disa aktivistë të Vetëvendosjes e kanë braktisur këtë parti dhe i janë bashkuar PDK-së", është shprehur ai.

Xhemajli ka deklaruar se çdo ditë po dëshmohet se PDK-ja është adresa më e fuqishme politike në vend për qytetarët. "PDK-ja, ashtu siç ka dëshmuar edhe në të kaluarën, po dëshmon edhe tani se është adresa më e sigurt politike për qytetarët e Kosovës. Platforma politike 'Dekada e Re', e ideuar nga kryetari Kadri Veseli, do ta fuqizojë dhe zhvillojë Republikën e Kosovës në rrugën e sigurt drejt integrimeve në Bashkimin Evropian dhe në NATO", ka thënë Xhemajli

# shkojnë dhe fuqizojnë PDK-në



**"Epoka e re":** *Z. Xhemajli, PDK-ja tashmë ka filluar edhe zgjedhjen e kryetarëve të degëve. Si po shkon ky proces zgjedhor?*
**Xhemajli:** Procesin e brendshëm zgjedhor PDK-ja e ka filluar para dy muajve. Fillimisht kemi pasur një fazë përgatitore në të cilën është dashur të kryhen disa detyra paraprakisht, në mënyrë që zgjedhjet të bëhen ashtu siç duhet. Synimi ynë në këto zgjedhje është të ofrojmë edhe njerëz të ri, të cilët ia ngrehin vlerën PDK-së. Pra, kemi dashur që në strukturat e partisë të zgjedhën njerëzit më të mirë që ka tani PDK-ja dhe personalitetet e reja, të cilat do të jenë vlerë e shtuar e partisë. Deri më tani ky proces ka shkuar ashtu siç është dashur. Ka qenë një proces fer, demokratik dhe korrekt.

**"Epoka e re":** *Kush po iu bashkëngjitet strukturave të PDK-së në këtë proces?*
**Xhemajli:** Deri më tani në këtë proces zgjedhor shumë të rinj dhe të reja u janë bashkangjitur strukturave të PDK-së. Por, ka raste që kanë ardhur në PDK edhe njerëz nga partitë e tjera, sidomos nga Lëvizja Vetëvendosje dhe AAK-ja. Përveç këtyre, na janë bashkuar edhe kuadrot e tjera profesionale si nga universitetet tona që kanë shprehur dëshirën e tyre ta japin kontributin në këtë parti. E rëndësishme të përmendi është se në këtë proces po na kthehen shumë aktivistë të PDK-së të cilët më parë kishin shkuar te partitë e tjera. Kthimi i tyre është një shenjë shumë e mirë për PDK-në. Deri më tani ne jemi të kënaqur me këtë proces, sepse çdo gjë ka shkuar sipas rregullores që kemi aprovuar në Këshillin Drejtues të PDK-së. Tani kemi filluar procesin e zgjedhjes së kryetarëve të degëve, ku në Degën e Kaçanikut është rikonfirmuar kryetar Besim Ilazi, i cili ka pasur një kundërkandidat. Procesi ka qenë një garë demokratike për t'u marrë lakmi. Vetëm në 24 nëndegët tona në Kaçanik janë angazhuar në struktura të PDK-së rreth 2 000 aktivistë. Besoj se i njëjti entuziazëm është edhe në degët e tjera në gjithë Kosovën.

**"Epoka e re":** *Keni ndonjë statistikë se sa është numri i atyre që për herë të parë po i bashkohen PDK-së?*
**Xhemajli:** Nuk kam ndonjë statistikë të saktë, por është një numër i kënaqshëm i këtyre të rinjve dhe të rejave që për herë të parë po i bashkohen PDK-së.

**"Epoka e re":** *Kthimi i atyre që kanë qenë në PDK po ndodh vetëm në ndonjë degë apo në shumë degë?*
**Xhemajli:** Besoj se tani është njëfarë trendi i kthimit të atyre që më herët e kanë lënë PDK-në për t'iu bashkuar partive të tjera. Për shembull, në Ferizaj më herët është kthyer Xhabir Morina, në Lipjan tani është kthyer doktori Fitim Selimi me shumë aktivistë të tjerë. Pra, në PDK nuk po kthehen vetëm individë, por shtresa të rëndësishme të shoqërisë. Pastaj në Shtime disa aktivistë të Vetëvendosjes e kanë braktisur këtë parti dhe i janë bashkuar PDK-së. Tani po ndodh një trend që PDK-së po i bashkohen ata aktivistë dhe struktura që më herët e kishin braktisur.

**"Epoka e re":** *Sa do ta konsolidojë PDK-në ky proces zgjedhor?*
**Xhemajli:** Synimi ynë si parti është që të dalim shumë më të fuqishëm nga ky proces zgjedhor. Në bazë të asaj që kam parë në terren, besoj shumë se do të dalim shumë më të fortë nga ky proces. Do të dalim më të fortë sepse në gjithë këtë proces konkurrues nëpër nëndegë deri më tani nuk ka pasur hatrime apo ndonjë përçarje. Pra, ky proces vetëm po na forcon dhe po na bashkon. Kjo natyrisht se do të bëjë që PDK-ja edhe më tutje ta mbajë trendin e drejtimit të institucioneve të Kosovës.

**"Epoka e re":** *Besoni se zgjedhjet e brendshme do ta rikthejnë PDK-në si parti të parë në vend?*
**Xhemajli:** Unë besoj se PDK-ja edhe tani është partia më e madhe në vend. Qytetarët deri më tani i kanë besuar kësaj partie si subjekti i parë. PDK-ja, ashtu siç ka dëshmuar edhe në të kaluarën, po dëshmon edhe tani se është adresa më e sigurt politike e qytetarëve të Kosovës. Platforma politike 'Dekada e Re', e ideuar nga kryetari Kadri Veseli, do ta fuqizojë dhe zhvillojë Republikën e Kosovës në rrugën e sigurt drejt integrimeve në Bashkimin Evropian dhe në NATO.

**"Epoka e re":** *Megjithatë, sondazhi i fundit i Lëvizjes Vetëvendosje PDK-në e ka nxjerrë subjektin e tretë politik në vend.*
**Xhemajli:** Dihet që në Kosovë sondazhet shpeshherë dinë të jenë të porositura. Nuk po them se ky aktuali ka qenë i porositur, por e dimë të gjithë se më herët në Kosovë kanë bërë sondazhe të tilla dhe më pas verdikti i elektorati të Kosovës ka qenë ndryshe nga ai që është prezantuar. Unë nuk di se çka kanë bërë për qytetarët e Kosovës këto dy subjekte politike që, sipas këtij sondazhi, qenkan parti të para. Nuk besoj se këto dy subjekte kanë bërë diçka për qytetarin e Kosovës që ai ta ndërrojë mendjen tash.

**"Epoka e re":** *Keni pretendime për t'i hyrë garës për kryetar të degës në Ferizaj?*
**Xhemajli:** Jo. Dihet që PDK-ja është kthyer fuqishëm në Komunën e Ferizajt dhe nuk kam ndonjë pretendim të tillë, ani pse kam pasur oferta. Ndërsa për Kryesi Qendrore të PDK-së sigurisht se do të garoj, edhe pse është herët të flitet për këtë çështje.

**"Epoka e re":** *Kur pritet të përmbyllet ky proces zgjedhor?*
**Xhemajli:** Nuk e kemi ndërmend të ngutemi në këtë drejtim. Ne duam të bëjmë zgjedhje të mira dhe kualitative. Besoj se në mars do të mund ta mbajmë konventën e partisë.

**"Epoka e re":** *Ende askush nuk ka shprehur gatishmëri për ta sfiduar z. Veselin për postin e të parit të PDK-së. A pritni që Veseli të ketë kundërkandidat?*
**Xhemajli:** Besoj se është herët të flitet për këtë çështje, por natyrisht se secili zyrtar i kësaj partie ka të drejtë të sprovohet në këtë drejtim. Deri më tani askush nuk e ka shprehur këtë ambicie, por ndoshta kur të vijë koha dikush do të paraqitet.

**"Epoka e re":** *Ju jeni një nga themeluesit e PDK-së dhe sigurisht se i keni përcjell edhe proceset e tjera të brendshme zgjedhore në PDK. Çfarë e dallon këtë proces zgjedhore prej atyre të mëparshmëve?*
**Xhemajli:** Nga fillimi çdoherë kam qenë në strukturat e larta të PDK-së. Me përgjegjësi e them se ky është procesi zgjedhor më demokratik që është mbajtur deri më tani. Çdo gjë prej fillimi deri më tani është bërë mbi bazën e dokumenteve që i kemi aprovuar në Këshillin Drejtues të PDK-së. Prandaj po them se këto zgjedhje jo që janë më të mirat që ka mbajtur ndonjëherë PDK-ja, por ky proces është shembull edhe për partitë e tjera në Kosovë se si duhet t'i bëjnë zgjedhjet e brendshme. Këtë e them me përgjegjësi të plotë, sepse e di goxha mirë se si partitë e tjera i mbajnë zgjedhjet e brendshme.

**"Epoka e re":** *Kohët e fundit është fituar përshtypja se vendin në zgjedhje mund ta çojë vetëm PDK-ja. Madje ka edhe paralajmërime të opinionistëve se kjo parti mund ta çojë vendin në zgjedhje të reja sërish në pranverë të këtij viti pasi ta përfundojë këtë proces të brendshëm zgjedhor. Mund të ndodhë kjo?*
**Xhemajli:** Mendoj se Qeveria e Kosovës është duke kryer punë të mëdha. Një nga to ishte formimi i ushtrisë, pastaj vendosja e taksës për mallrat serbe. Tani PDK-ja nuk mendon se duhet të mbahen zgjedhjet e parakohshme së shpejti siç po pretendojnë rivalët tanë politikë. Kjo nuk duhet të ndodhë sepse kemi shumë punë përpara. Mendoj se Kosovës nuk i konvenon që të ketë zgjedhje të reja në një të ardhme të afërt.

**"Epoka e re":** *Pra, PDK-ja nuk do ta çojë vendin në zgjedhje nëse sheh disponim në strukturat e veta të reja?*
**Xhemajli:** PDK-ja as më herët nuk e ka çuar vendin në zgjedhje të parakohshme për interesa të veta të ngushta. Zgjedhjet kanë ardhur në shprehje vetëm kur kemi pasur ngecje në procesin e vendimmarrjes së Qeverisë. Të gjithë e dimë se Qeveria e kaluar nuk mund të merrte vendime të mëdha për vendin, prandaj zgjedhjet ishin të nevojshme. Konsolidimin tonë në struktura nuk po e bëjmë për ta çuar vendin në zgjedhje të parakohshme. Ne atë po e bëjmë për ta fuqizuar partinë sepse e kemi edhe obligim me statut dhe dokumente të tjera partiake.

## Ministri Pacolli të enjten në Berlin takon homologun gjerman Maas



PRISHTINË, 8 JANAR (ER) - Me ftesë të ministrit të Punëve të Jashtme të Qeverisë së Gjermanisë, Heiko Maas, zëvendëskryeministri i parë i Qeverisë së Kosovës dhe ministri i Jashtëm, Behgjet Pacolli, të enjten do të udhëtojë në Berlin, ku do të pritet nga homologu gjerman Heiko Maas. "Maas dhe Pacolli do të bisedojnë për temat aktuale, me fokus të veçantë në marrëdhëniet bilaterale në mes të Gjermanisë dhe Kosovës, duke filluar nga nevoja e pranisë edhe më të madhe të ekonomisë dhe investimeve gjermane në Kosovë, njohja reciproke e patentshoferëve në mes të shtetasve të Gjermanisë dhe Kosovës, përkrahja e mëtejshme e diplomacisë së Gjermanisë në njohjet e shtetit të Kosovës", është thënë në komunikatën e MPJ-së, duke bërë me dije se në fokus të veçantë do të jetë edhe çështja e liberalizimit të vizave për Kosovën si dhe negociatat për marrëveshjen përfundimtare në mes të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë, ku Gjermania luan rol të rëndësishëm. Ministrat Maas dhe Pacolli pas takimit do të mbajnë konferencë të përbashkët për shtyp.

# Qytetarët të shqetësuar nga grabitjet e armatosura

Kohët e fundit janë shpeshtuar rastet e grabitjeve të armatosura në Kosovë, duke u bërë kështu dukuri mjaft shqetësuese. Cak i grabitjeve kanë qenë shtëpitë private, dyqanet e bizneseve si dhe bankat



PRISHTINË, 8 JANAR - Në fund të dhjetorit një polic u vra në detyrë përderisa po përpiqej të kapte një të dyshuar për grabitje në një bankë në qytetin e Istogut, ku më pas i vrarë mbeti edhe personi i dyshuar për plaçkitje. Pak javë para këtij rasti, në periferi të Prishtinës policia kishte konfirmuar se një person kishte mbetur i vrarë përderisa po përpiqej të plaçkiste një shtëpi private.

Vjollca Jusufi është një nga viktimat e hajnave, biznesi i së cilës ishte plaçkitur. Ajo ka thënë për "Radion Evropa e Lirë" se dëmi që i është shkaktuar nga grabitësit, të cilët ia kishin thyer lokalin, ka qenë rreth 6 000 euro. Jusufi tregon se policia ende nuk i ka kapur grabitësit, ndonëse ngjarja ka ndodhur rreth një muaj më parë. "Rreth orës 2:00 pas mesnate katër plaçkitës e kanë thyer lokalin tonë. Kanë qenë me maska. Kanë vjedhur mall në vlerë afër 6 000 euro. Plaçkitësit asnjëherë nuk janë kapur nga policia. Të gjithë ngjarjen më pas e kemi parë në kamerë. Në orën 6:00 të mëngjesit e kemi gjetur lokalin e thyer dhe kemi njoftuar policinë", ka thënë Jusufi.

Statistikat e Policisë së Kosovës flasin se për periudhën janar-nëntor të vitit 2018, aq sa kanë pasur të dhëna autoritetet e rendit, kanë qenë 263 raste të grabitjeve.

Daut Hoxha, zëdhënës në Policinë e Kosovës, ka pohuar se vetëm në rajonin e Prishtinës, ku rastet e grabitjeve janë më të shpeshta, janë arrestuar 32 persona të dyshuar, të cilët janë në paraburgim, kurse 6 të dyshuar të tjerë, të identifikuar nga policia, janë në arrati. "Grabitja si vepër penale kryhet në rrethana të ndryshme, por rastet më serioze të grabitjeve janë ato me armë. Po ashtu, grabitësit kanë pasur caqe të ndryshme si biznese, banka, shtëpi banimi, edhe grabitjen e gjësendeve nga dora apo krahu. Policia, me qëllim të parandalimit, hetimit dhe arrestimit të kryerësve të këtyre akteve, ka realizuar dhe ka zbatuar plane operative dhe taktike. Po ashtu, të arrestuar dhe dërguar para organeve të drejtësisë ka edhe të dyshuar të tjerë në rajonet e tjera, edhe pse në rajonet e tjera ka dukshëm më pak raste të tilla", ka thënë Hoxha.

Ndërkaq, Shoqata e Bankave të Kosovës ditë më parë përmes një komunikate për media u ka bërë thirrje institucioneve të sigurisë në Kosovë "që të ndërmarrin masa urgjente dhe të fuqishme kundër këtyre grupeve kriminale për t'i shpartalluar ato dhe për të siguruar mjedis të sigurt për bizneset e Kosovës", duke u dhënë vëmendje të veçantë institucioneve financiare. "Gjatë vitit 2018, sektori bankar në Kosovë është ballafaquar me një numër të paprecedentë të rasteve të sulmeve fizike, ku shumica prej tyre ishin grabitje të kryera nga grupe të rrezikshme kriminale, të armatosura me armë të gjata. Derisa dëmet materiale ishin të larta, Shoqata e Bankave të Kosovës shpreh shqetësimin më të madh për sigurinë e klientëve dhe stafit të bankave. Në disa nga këto sulme punonjësit e bankave janë lënduar dhe është dashur të pranojnë trajtim mjekësor", theksohet në deklaratën e Shoqatës së Bankave.

Bazuar në statistikat e Policisë së Kosovës, gjatë vitit 2017 janë evidentuar gjithsej 290 raste të grabitjeve nga ana e plaçkitësve, ku grabitësit kanë pasur caqe të ndryshme si biznese, banka, shtëpi banimi dhe grabitjen e gjësendeve nga dora apo krahu.

## PDK-ja fillon zgjedhjen e kryetarëve të degëve

PRISHTINË, 8 JANAR (ER) - Partia Demokratike e Kosovës (PDK) ka mbajtur kuvendin zgjedhor në degën e Kaçanikut, pas përmbylljes së suksesshme të zgjedhjeve në 24 nëndegë të kësaj komune, ku morën pjesë mbi 2 000 aktivistë të PDK-së. Në garën për kryetar të degës kandiduan Besim Ilazi dhe Azem Guri, ndërsa pas numërimit të votave të 157 delegatëve, Besim Ilazi u konfirmua kryetar i Degës së PDK-së në Kaçanik, kurse mori mbështetjen për bashkëpunim edhe nga kundërkandidati i tij, Azem Guri.

Nënkryetari i PDK-së, Bajrush Xhemajli, tha para delegatëve se zgjedhjet në Partinë Demokratike janë duke dëshmuar sërish adresën më të sigurt politike të qytetarëve të Kosovës. Xhemajli tha se platforma politike, Dekada e Re, e ideuar nga kryetari Kadri Veseli, do ta fuqizojë dhe zhvillojë Republikën e Kosovës në rrugën e sigurt drejt integrimeve në Bashkimin Evropian dhe në NATO.

Pas zgjedhjes së kryetarit të Degës së PDK-së në Kaçanik, delegatët pjesëmarrës zgjodhën edhe 45 anëtarët e këshillit drejtues të degës si dhe 14 delegatë për konventën qendrore të partisë.

Partia Demokratike e Kosovës deri tani ka mbajtur zgjedhjet në rreth 300 nëndegë të saj, ndërsa deri në fund të procesit zgjedhor do të mbahen edhe zgjedhjet në 900 nëndegë, për t'u përmbyllur zgjedhjet me konventën qendrore të partisë, ku do të zgjidhen edhe kryetari, këshilli drejtues dhe kryesia qendrore.



# Haradinaj zotohet se do të merren parasysh kërkesat e SBAShK-ut

Faton DËRMAKU



PRISHTINË, 8 JANAR - Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka pritur të martën në takim kryetarin e Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës (SBAShK), Rrahman Jasharaj. Me këtë rast, kryeministri është zotuar se para votimit të Projektligjit për paga do të merren parasysh disa prej kërkesave të sindikatës dhe mësimdhënësve. "Rritja e buxhetit në arsim është një nga hapat e shumtë që kemi ndërmarrë si Qeveri për ta përmirësuar gjendjen në këtë sektor. Krahas kësaj, është bërë edhe punë e madhe me Ligjin e Pagave, duke i zyrtarizuar pagat e mësimdhënësve që deri tani bazoheshin në vendime dhe në shtesa të rrezikshmërisë. Përfaqësuesit e Sindikatës së Bashkuar të Arsimit i njoftova për nevojën që ky ligj të kalojë sa më parë në Kuvendin e Kosovës dhe pas kësaj të hapet rrugë për t'i bërë përmirësimet e nevojshme në të ardhmen. Po sot u zotuam se do të angazhohemi bashkërisht që përpara votimit në Kuvend të merren parasysh disa prej kërkesave të sindikatës dhe mësimdhënësve", ka thënë Haradinaj pas takimit me Jasharaj.

Kryetari i Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, të Shkencës dhe të Kulturës (SBAShK), Rrahman Jasharaj, disa ditë më parë në një intervistë për "Epokën e re" pati bërë me dije se më 14 janar nis greva nëse nuk realizohen kërkesat e SBAShK-ut. "Deri më 14 janar institucionet kanë kohë për të reflektuar në mënyrë që të ulemi së bashku dhe të gjejmë një zgjidhje të pranueshme. SBAShK-u nuk po kërkon diçka që nuk mund të realizohet, por kafshata që ndahet duhet të jetë e barabartë për të gjithë. Pra, nuk është në rregull që disa sektorëve t'u plotësohen të gjitha kërkesat, ndërsa arsimit të mos i plotësohet asnjë kërkesë. Po kërkojmë barazi dhe vend meritor në ligjin e pagave. Mësuesi duhet të këtë tretman në shoqëri, pastaj të kërkohet nga ai punë dhe rezultate. Nëse institucionet nuk reagojnë, nuk kemi zgjidhje tjetër. Jemi të vetëdijshëm se greva e përgjithshme në kohë të pacaktuar do ta destabilizojë procesin mësimor, mirëpo për këtë përgjegjësinë e kanë institucionet sepse ne kemi bërë të pamundurën për ta arritur zgjidhjen e çështjeve me dialog. Kërkesat e SBAShK-ut duhet të realizohen sepse janë të ligjshme. Edhe kryeministri Haradinaj edhe ministri Bytyqi publikisht kanë thënë se koeficientët aktualë nuk janë në rregull dhe se arsimi nuk e meriton pozitën që e ka në Projektligjin për paga, por e meriton një vend meritor", ka thënë Jasharaj.

# Kurti takon ambasadorin e Zvicrës, ia prezanton qëndrimin për dialogun



PRISHTINË, 8 JANAR (ER) - Kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, ka pritur të martën në takim ambasadorin e Zvicrës në Kosovë, Jean-Hubert Lebet. Në këtë takim Kurti i ka prezantuar ambasadorit qëndrimet e Lëvizjes Vetëvendosje mbi situatën e përgjithshme në Kosovë, veçanërisht mbi zhvillimet e fundit politike që kanë të bëjnë me dialogun me Serbinë. Sipas një komunikate për medie të LV-së, në takim është biseduar edhe për gjendjen e rëndë ekonomike në vendin tonë dhe korrupsionin e lartë.

Kryetari Kurti e ka njoftuar ambasadorin Lebet me programin e Lëvizjes dhe propozimet tona për të dalë nga kjo krizë duke stimuluar zhvillimin ekonomik për krijimin e vendeve të punës si dhe për shtetin e së drejtës i cili e mban ligjin mbi politikën. Po ashtu, është diskutuar edhe për rëndësinë e marrëdhënieve sa më të mira në mes të Kosovës dhe Zvicrës si dhe mundësitë për ta thelluar e zgjeruar bashkëpunimin në interes të ndërsjellë të dy vendeve. Në fund të takimit palët janë pajtuar për vazhdimin e komunikimit dhe të takimeve të rregullta.

## 2019-a shpallet vit i NATO-s në Kosovë

PRISHTINË, 8 JANAR (ER) - Presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, e ka shpallur vitin 2019, vit të NATO-s në Kosovë. Në këtë vit shënohet 20-vjetori i intervenimit humanitar të NATO-s në Kosovë, intervenim ky që kishte ndodhur pas masakrave, spastrimit etnik dhe krimeve të forcave serbe mbi popullatën civile në Kosovë, si dhe pas dështimit të përpjekjeve diplomatike botërore për gjetjen e një zgjidhjeje paqësore për Kosovën. Më 24 mars 1999 forcat ajrore të NATO-s e kishin nisur fushatën e bombardimeve kundër caqeve të shtetit serb, që kishte zgjatur gjithsej 78 ditë, duke ndalur gjenocidin dhe sjellë lirinë për Kosovën. Populli i Kosovës do t'u jetë përjetësisht mirënjohës shteteve anëtare të NATO-s për mbështetjen.



# Begaj kërkon nga drejtorët realizim të objektivave për vitin 2019

Malishevë, 8 janar (ER) - Kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, ka mbajtur mbledhjen e parë për vitin 2019 të Këshillit të Drejtorëve, me të cilët ka biseduar për punët e kryera gjatë vitit 2018 dhe përgatitjet për vitin 2019.
Kryetari Begaj i ka uruar drejtorët për punët e kryera si dhe është zotuar për më shumë angazhim në vitin 2019. Drejtorët e drejtorive komunale kanë prezantuar punët e tyre gjatë vitit të kaluar dhe planifikimet për vitin 2019.
Gjatë raportimit të drejtorëve u bë me dije se buxheti komunal për vitin 2018, edhe pse ende nuk është përgatitur raporti përfundimtar, është shpenzuar rreth 98 për qind, po ashtu aq janë realizuar edhe të hyrat vetjake, kurse të hyrat nga tatimi në pronë janë realizuar rreth 96 për qind.
Begaj ka kërkuar nga të gjithë drejtorët që gjatë këtij viti të jenë të angazhuar maksimalisht për realizimin e të gjitha objektivave dhe planifikimeve si dhe të jenë të shërbim të qytetarëve.






# Komuna e Mitrovicës së jugut përmbyll vitin 2018 pa asnjë vrasje

**Mitrovicë, 8 janar (ER)** - Bazuar në vlerësimet analitike të bëra në raportet periodike përgjatë vitit 2018, në zonën e përgjegjësisë së Drejtorisë Rajonale në Mitrovicë viti 2018 shënon rënie të përgjithshme të incidenteve dhe rasteve të tjera penale. Kështu ka bërë me dije komandanti i Stacionit Policor në Jug, kapiteni Ahmet Xhosha, gjatë prezantimit të punës të martën në Stacionin Jugor të Policisë në Mitrovicë. Ai ka thënë se rënia e numrit të rasteve në përgjithësi rezulton me efikasitetin dhe bashkëveprimin ndërmjet njësive e sektorëve të ndryshëm. "Në fushën e veprave penale gjatë vitit 2018 nuk është shënuar asnjë rast i vrasjes në zonën e Drejtorisë Rajonale në Mitrovicë. Ky rezultat reflekton angazhimet e vazhdueshme policore dhe masat e ndërmarra në parandalimin e veprave penale", ka thënë kapiten Xhosha.
Në fjalën e tij toger Fitim Zahiti, duke folur për detajet e raportit, ka theksuar se numri i përgjithshëm i rasteve kriminale në vitin 2018 ka shënuar rënie për 15.8 për qind më pak në krahasim me vitin paraprak, ai i veprave penale 9 për qind, ndërsa ai i veprave penale kundër pasurisë 16.2 për qind më pak. Po ashtu, toger Zahiti ka bërë me dije se edhe numri i përgjithshëm i aksidenteve në vitin 2018 është zvogëluar për 31.4 për qind më pak në krahasim me vitin paraprak. "Llogaritet si sukses shumë i mirë, se zbulueshmëria e veprave të përgjithshme kriminale në vitin 2018 është zbritur në 70.4 për qind për vitin 2018", ka thënë Zahiti, duke shtuar se që nga viti 2013-2018 ka rënie të rasteve të raportuara në përgjithësi prej 52.9 përqindësh.
Në anën tjetër, drejtoresha e Policisë Rajonale të Mitrovicës, nënkolonele Afërdita Mikullovci, ka theksuar se nga të dhënat e publikuara shihet qartë se objektivat e policisë janë arritur në vitin 2018 dhe kjo, sipas saj, është për t'u vlerësuar.

# Vetëvendosja dorëzon kallëzim penal ndaj Shpend Ahmetit



**Prishtinë, 8 janar (ER)** - Aktivistët e Qendrës së Lëvizjes Vetëvendosje në Prishtinë kanë dorëzuar të martën në prokurori kallëzimin penal ndaj kryetarit të Komunës së Prishtinës, Shpend Ahmeti, për keqpërdorim të detyrës zyrtare dhe për lidhje të kontratës së dëmshme. Me këtë rast, aktivisti i Vetëvendosjes, Valdrin Ahmeti, ka deklaruar se dorëzimi në prokurori i këtij kallëzimi penal ndaj kryetarit Shpend Ahmeti ka të bëjë me keqpërdorimin e 530 mijë euro në tenderin për furnizim me qumësht për nxënësit e klasave I-V. "Në vitin 2017, saktësisht më 5 tetor, Komuna e Prishtinës publikon njoftimin për kontratë ku, çuditërisht, vlera e parashikuar e tenderit nga 200 mijë euro sa ishte në vitin paraprak, bëhet 730 mijë euro. Vlera e parashikuar e tenderit është rritur për 530 mijë euro nga ana e Komunës së Prishtinës", ka deklaruar ai. Sipas tij, me këtë ndryshim në tender nga viti në vit, Shpend Ahmeti ka dëmtuar buxhetin e Komunës së Prishtinës mbi 530 mijë euro. "Shpend Ahmeti duhet të mbajë përgjegjësi publike morale dhe politike para qytetarëve të Prishtinës e gjithë Kosovës për këto 530 mijë euro, por pas këtij kallëzimi penal ai duhet të mbajë edhe përgjegjësi penale për këtë keqpërdorim flagrant të parasë publike. Shpend Ahmeti duhet të tregojë ku janë 530 mijë euro? Çfarë borxhi u ka Shpend Ahmeti Devollëve që i ka shpërblyer me 530 mijë euro?", është shprehur Valdrin Ahmeti.

## Mbahet sesion informues për përkrahjen e bizneseve në Ferizaj

**Ferizaj, 8 janar (ER)** - Në Komunën e Ferizajt është mbajtur një sesion informues në lidhje me platformën për përkrahjen e bizneseve të quajtur "Fondi i punësimit". Sipas zyrtarëve të kësaj komune, kjo platformë do të ndikojë drejtpërdrejt në rritjen e punësimit përmes subvencionimit të bizneseve, me qëllim të zhvillimit ekonomik dhe krijimit të vendeve të reja të punës dhe fuqizimin e bizneseve në fushën e prodhimit.
Drejtori i Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit, Zekir Bytyqi, ka thënë se përmes këtij projekti do të ofrohen pajisje në mënyrë që përfituesit të mund ta rrisin biznesin e tyre. "Platforma e kryetarit Aliu ka qenë edhe fondi i punësimit i cili është parapare që të ndikojë drejtpërdrejt në rritjen e numrit të punëtorëve në Komunën e Ferizajt. Përzgjedhja e përfituesit bëhet në mënyrë konkurruese, ndërsa shuma e grantit përcaktohet nga plotësimi i disa kritereve të cilat janë paraparë", ka thënë drejtori Bytyqi. Vlera e një granti për një përfitues do të jetë 2 000 deri në 5 000 euro, shumë kjo e cila përfshinë edhe investimin nga përfituesit prej 20 përqindësh, ndërsa planifikohet që të ndihmohen rreth 30 biznese të Komunës së Ferizajt.



# Shala pret në takim Haradinajn, 2019-ta vit i investimeve strategjike




EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 8 JANAR - Ministri i Tregtisë dhe Industrisë, Endrit Shala, ka pritur të martën në takim kryeministrin e Kosovës, Ramush Haradinaj, ku është diskutuar për klimën e investimeve në Kosovë dhe prioritetet e MTI-së gjatë vitit 2019. Ministri Shala ka thënë se ky vit do të jetë i investimeve strategjike, ku bëri me dije se me Ligjin për Investime Strategjike deri më tani kanë aplikuar 11 kompani, e që vlera e investimit është 1 miliard e 800 milionë euro. "Kisha nderin që ta kem në MTI kryeministrin e Kosovës, Ramush Haradinaj, të cilin e njoftova me prioritetet e MTI-së për vitin 2019. Fokusi kryesor gjatë takimit me kryeministrin kanë qenë investimet strategjike, kompetencë kjo e MTI-së. E njoftova kryeministrin që kanë ardhur 11 investitorë strategjikë, investime këto që kapin shifrën e 1 miliard e 800 milionë euro, e që shumë shpejt, pas ndryshimeve të fundit me ligjin që kemi bërë, mendoj se fillim të këtij muaji ta nisim shpalljen e investitorëve strategjikë. Po ashtu, temë e takimit me kryeministrin ishin edhe prioritetet e tjera të MTI-së, që mendojmë t'i zhvillojmë dhe realizojmë gjatë këtij viti, që janë ekonomia, zhvillimi i vendit tonë, përkrahja e prodhuesit vendorë dhe përkrahja e bizneseve", ka thënë ministri Shala.

Ndërsa kryeministri Ramush Haradinaj ka falënderuar ministrin Shala për punën dhe angazhimin që, sipas tij, është hetuar në përmbajtje. Haradinaj ka theksuar se ka lajme të mira sa iu përket investitorëve strategjikë, duke nënvizuar që shumë shpejt do të shpallen investitorët strategjikë. "Është pak rastësi që po fillojmë vitin e punës me vizitën e parë në MTI. Biseduam për zhvillimet dhe për objektivat. E falënderova ministrin për angazhim që vërtet hetohet në përmbajtje. Tani para vetes kemi një periudhë të mirë dhe kemi lajme të mira se e gjitha rregullativa dhe legjislacioni është gati për të shkuar drejt shpalljes së investitorëve të parë strategjikë, që e kemi pritur që dy dekada. Mora vesh nga ministri që në dhjetë ditët e para mund të shpallet investitori i parë strategjik dhe shpresoj se Kosova do ta marrë këtë lajm dhe kësisoj do të pasojnë edhe 11 investitorë strategjikë në kualifikim e sipër që kapin vlerën afër 2 miliardë euro investime, shumica janë në energji, transport e rurizëm. Pra, kemi hyrë në një fazë intensive të zhvillimit të vendit", ka thënë kryeministri Haradinaj.

# ATK-ja: Afati për regjistrimin e mallrave në stoqe, deri më 10 janar

EPOKA E RE A. MAVRAJ

PRISHTINË, 8 JANAR - Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) ka njoftuar se në bazë të Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat, tatimpaguesit duhet t'i regjistrojnë mallrat në stoqe në fund të vitit kalendarik. Sipas ATK-së, regjistrimi i tillë duhet të jetë i gatshëm më së largu deri më 10 janar të vitit 2019. "Çdo tatimpagues, pa marrë parasysh qarkullimin vjetor, përveç mbajtjes së librave dhe regjistrave të parapara me ligj, kërkohet ta kryejë regjistrimin e mallrave në stoqe në fund të vitit kalendarik. Regjistrimi i tillë duhet të përfundohet më,




apo para datës 10 janar të vitit vijues dhe të jetë në dispozicion për inspektim me kërkesën e Administratës Tatimore të Kosovës", thuhet në njoftimin e ATK-së.

ATK-ja me anë të këtij njoftimi tregon se shënimet e regjistrimit të mallrave duhet ta përfshijë emërtimin e mallit, njësinë matëse, sasinë, çmimin dhe vlerën e mallit, ndërsa regjistrimi i mallrave duhet të mbahet me çmimin e kostos. ATK-ja ka rikujtuar të gjithë tatimpaguesit të cilët nuk respektojnë afatin e paraparë për t'i regjistruar mallrat në stoqe, se do të jenë objekt i masave ndëshkuese të parapara me legjislacionin tatimor të Kosovës.

## Hapet afati për aplikim për rimbursim nga kuponët fiskalë

Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) ka njoftuar qytetarët se nga data 1 janar i këtij viti mund të aplikojnë për rimbursim nga kuponët fiskalë. Aplikimi për rimbursim të mjeteve nga grumbullimi i kuponëve fiskalë për tremujorin e parë 2019 ka filluar nga data 1 janar 2019 dhe vazhdon deri më 31 janar. "Aplikimi bëhet duke plotësuar aplikacionin për rimbursim të mjeteve nga grumbullimi i kuponëve fiskalë. Aplikacioni duhet të plotësohet në mënyrë elektronike përmes uebfaqes së Administratës Tatimore të Kosovës në linkun Shërbime Elektronike - Aplikacioni për Kuponë Fiskalë. Aplikimi bëhet vetëm një herë për të njëjtën periudhë duke u bazuar në numrin personal të aplikuesit. Fituesit potencialë do të rimbursohen me 10 për qind të vlerës së deklaruar, por jo më shumë se 100 euro. Numri minimal i kuponëve fiskalë të dorëzuar duhet të jetë 60 kuponë, me shumën minimale 250 euro", është thënë në njoftimin e ATK-së.

# Asimetritë midis dialogut të brendshëm dhe dialogut me fqinjët



Shkruan: Lisen BASHKURTI

Një proces dialogu ka përfshirë vendet e Ballkanit Perëndimor ndërmjet tyre. Mirëpo, në të njëjtën kohë ky rajon po përfshihet në një valë protestash masive. Shkaqet e protestave, me ndonjë përjashtim të rrallë, janë pak a shumë të njëjta. Krizat ekonomike dhe pasojat sociale, krizat politike nga qeverisjet e dobëta dhe prirjet autoritariste, korrupsioni dhe krimi i organizuar në nivele të larta, mungesat e shtetit ligjor dhe të sistemit të drejtësisë, dobësitë në funksionimin e demokracisë, shkeljet e të drejtave të njeriut, injorimi i opozitave politike dhe kapja e medieve. Këto procese të trazuara të brendshme po kërcënojnë procesin e dialogut rajonal.

Ballkani Perëndimor vazhdon të jetë në tranzicion. Tranzicionin, siç merret me mend, e zgjat mosadresimi në kohë i problemeve ekonomike dhe sociale që kanë sjellë akumulimin e tyre, rritja e pakënaqësisë së masave, rënia e besimit te qeverisjet dhe fryma përjashtuese e aktorëve politikë dhe joshtetërorë në politikëbërje dhe vendimmarrje.

Mbi të gjitha, në vendet e Ballkanit Perëndimor vërehet polarizim i skajshëm politik mazhorancë-opozitë, sikundër edhe midis aktorëve shtetërorë dhe joshtetërorë. Mungon gjithëpërfshirja si një prej vlerave më të rëndësishme të demokracisë. Pjesëmarrja në politikëbërje, draftim-ligjesh, vendimmarrje është e kufizuar në fare pak faktorë, të cilët janë të lidhur dhe shpesh të varur nga grupe të caktuara interesi, me fije korruptive dhe kriminale. Sjellja politike në Ballkanin Perëndimorë vazhdon të jetë me dy standarde: ndërkohë që flitet për dialog ndërkombëtar, injorohet tërësisht dialogu i brendshëm. Kjo asimetri ka shumë pasoja të rrezikshme.

## 1. Mungesa e dialogut të brendshëm rrënon themelet e demokracisë

Në Ballkanin Perëndimor mungon dialogu institucional, politik dhe shoqëror. Mungesa e dialogut është e pranishme thuajse në të gjithë demokracitë dhe shoqëritë ballkanike. Kudo vërehen mazhoranca që përdorin, shpërdorin dhe abuzojnë fuqinë e kartonit në legjislative, për rrjedhojë edhe në politikëbërje, vendimmarrje dhe projekte dhe financime publike.

Opozitat ndihen përgjithësisht të margjinalizuara. Participimi i tyre në jetën politike e institucionale është i paralizuar ose përjashtuar. Opozitat trajtohen nga mazhorancat si djalli i shoqërisë, si pengesa serioze përparimi, si faktorë të dështuar nga humbjet e së kaluarës dhe si armiq kërcënues të së ardhmes. Për çdo problem dhe sfidë opozitat fajësohen nga mazhorancat si shkaktaret kryesore. Për çdo arritje dhe sukses mazhorancat mburren dhe propagandohen si forcat e vetme progresive.

Kjo sjellje politike mazhorancash ka provokuar reagime në jo pak raste të skajshme edhe të opozitave. Duke u ndier të shpërfillura, të përjashtuara nga proceset, madje edhe të damkosura dhe baltosura pafundësisht, opozitat po përdorin forma politike radikale, siç janë bojkotet parlamentare, protestat e rrugëve dhe pakënaqësitë e shtresave të ndryshme shoqërore.

Marrëdhëniet mazhorancë-opozitë po sjellin polarizim të skajshëm politik në Ballkanin Perëndimor. Thellimi i këtij hendeku mazhorancë-opozitë po krijon përçarje politike kombëtare, mungesë të kohezionit social dhe përplasje në koabitacionin midis institucioneve shtetërore, qeveri-qendrore dhe qeveri-vendore. Në këtë situatë konfrontuese shoqëria civile, grupet e interesit dhe media ose po bëhen shtojca të mazhorancave ose po zhyten në kaos me paqartësi në mendimet, qëndrimet dhe veprimet e tyre.

Mungesa e kulturës dhe vullnetit për dialog të brendshëm ka dobësuar së tepërmi komunikimet midis aktorëve shtetërorë, politikë dhe shoqërorë në Ballkanin Perëndimor. Për rrjedhojë nuk ka pjesëmarrje demokratike. Strategjitë, politikat publike, platformat qeverisëse, ligjet, buxhetet hartohen dhe miratohen në mungesë të plotë dialogu. Për rrjedhojë, strategjitë, politikat publike, platformat qeverisëse, ligjet, buxhetet dhe projektet e ndryshme ndeshin në kundërshtime të mëdha, çka pamundëson ose vonon zbatimin e tyre, ose sjellin zbatimin e pjesshëm të tyre.

Polarizimi politik, mungesa e kohezionit social dhe e koabitacionit institucional ka bërë që shumë aktorë politikë, socialë dhe institucionalë në shoqëritë e Ballkanit Perëndimor t'i kundërvihen haptazi zbatimit të ligjeve, platformave qeverisëse, projekteve publike e publike-private të miratuara njëanshmërisht nga mazhorancat. Mungesa e dialogut konstruktiv dhe permanent ndërmjet gjithë aktorëve shtetërorë, politikë dhe shoqërorë në Ballkanin Perëndimor po dëmton seriozisht zbatimin e ligjeve, vendimeve, politikave dhe projekteve të ndryshme. Fryma përjashtuese në politikëbërje dhe vendimmarrje po provokon frymë kundërshtuese dhe moszbatuese të ligjeve. Baza e ngushtë në politikëbërje dhe vendimmarrje po kundërshtohet nga baza e gjerë opozitare, shoqërore dhe grupet e interesit. Ligjet nuk implementohen. Shteti ligjor nuk po funksionon. Shteti i së drejtës është i cunguar dhe i kërcënuar.

## 2. Mungesa e dialogut të brendshëm rrezikon dialogun fqinjësor

Shtetet e Ballkanit Perëndimor ballafaqohen me problematika të shumta ndërmjet tyre. Në themel të këtyre problematikave janë marrëdhëniet fqinjësore. Dhe në agjendat problematike fqinjësore qëndrojnë probleme kufijsh dhe pretendime territoriale, probleme pakicash dhe tendenca separatiste, probleme historike dhe politizime të tyre, probleme sigurie për shkaqe kontrabandash, krimi, trafiqesh të paligjshme, pastrime parash dhe rreziqesh terroriste, probleme kulturore e konfesioni fetar dhe fobitë ndaj tyre.

Gjithë kjo gamë e gjerë problematikash fqinjësore është thirrje serioze dhe emergjente për dialog midis shteteve të Ballkanit Perëndimor. Formalisht ka nisur dhe vazhdon një dialog ndërshtetëror. Por, ky dialog ndërshtetëror ndërkombëtar po ngrihet mbi mungesën e dialogut të brendshëm edhe për këto çështje.

Dialogu Kosovë - Serbi po ngrihet mbi përjashtimin e opozitave si në Prishtinë ashtu edhe në Beograd. Opozitat në Prishtinë dhe në Beograd si dhe grupe të caktuara politike, shoqërore dhe interesi po kundërshtojnë dialogun me arsyetime të ndryshme. Ndërkohë, mazhorancat në vend se të bëjnë përpjekje për përfshirjen në një bazë sa më të gjerë të aktorëve politikë e shoqërorë në proces, po i anashkalojnë, madje po i fajësojnë ato për dështimet e dialogut.

Dialogu Greqi - Maqedoni arriti të formalizohet me Marrëveshjen e Prespës për ndryshimin e emrit të Maqedonisë, duke zgjidhur një kontest shumëvjeçar midis dy vendeve. Mirëpo arritja pozitive e këtij formalizimi po ndeshet në rezistencë kundërshtuese të opozitave dhe të faktorëve të tjerë në të dy vendet. Në Maqedoni opozita dhe presidenti i vendit po bëjnë çdo përpjekje për t'i penguar ndryshimet kushtetuese që do ta funksionalizonin Marrëveshjen e Prespës. Dialogu politik mazhorancë-opozitë, sikundër edhe parlament-president, po sforcon së tepërmi implementimin e Marrëveshjes së Prespës në Maqedoni. Ndërkohë, edhe në Greqi opozita greke dhe faktorë të tjerë grekë po ngulin këmbë që Marrëveshja e Prespës të anulohet. Mungesa e dialogut të brendshëm si në Maqedoni ashtu edhe në Greqi duket se po pengon zbatimin e marrëveshjes.

Dialogu Shqipëri - Greqi për një paketë marrëveshjesh midis dy vendeve, me gjithë ulje-ngritjet e paqartësitë e tij, u duk se po ecte në një farë mënyre. Në këtë paketë përshihen delimitimi i kufirit detar, përcaktimi i kufirit tokësor, zgjidhje të disa problematikave historike siç është heqja e ligjit të luftës me Shqipërinë nga Greqia, problemi i varrezave të ushtarëve grekë të vrarë në Shqipëri gjatë betejave italo-greke të Luftës së Dytë Botërore si dhe një sërë problemesh të tjera aktuale.

Ky dialog, ende i paqartë dhe jo mjaftueshëm transparent, po ndeshet në kundërshtime serioze të brendshme si në Greqi, po ashtu edhe në Shqipëri. Opozita dhe faktorë të tjerë grekë po kundërshtojnë heqjen e ligjit të luftës me Shqipërinë, kanë fshirë nga agjenda diplomatike çështjen çame, po përplasen në qasjet ndaj delimitimit të kufirit detar, po shpalosin pretendime anakronike lidhur me pakicat dhe pronat e tyre në jug të Shqipërisë dhe po demonstrojnë dukuri vorio-epirote dhe tendenca shqiptaro-fobe. Në Shqipëri opozita dhe faktorë të tjerë po ashpërsojnë tonet lidhur me mënyrën se si po bëhen bisedimet, për versionet e përfolura të kufirit detar, për çështjen çame dhe ligjin e luftës, për varrezat e ushtarëve grekë dhe aspekte të pakicave greke në jug të Shqipërisë. Pra, ecuria e dialogut diplomatik ndërshtetëror po ndesh në kundërshtime serioze nga mungesa e dialogut të brendshëm politik dhe institucional në të dy vendet.

## 3. Dy standardet ndaj dialogut, pjesë e farsës ballkanike

Në Ballkanin Perëndimor demokracia po aplikohet me shumë standarde. Edhe në qasjen ndaj dialogut vërehen dy standarde. Ka mungesë të thellë dhe serioze të dialogut të brendshëm, ka frymë përjashtuese, mungesë kompromisesh dhe konsensusi, mungesë koabitacioni ndërinstitucional dhe uniteti edhe për çështje me rëndësi publike dhe kombëtare.

Nga ana tjetër, vendet e Ballkanit Perëndimor hiqen sikur performojnë në frymë demokratike e perëndimore lidhur me dialogun me fqinjët. Pak për arsye të presionit të BE-së, NATO-s dhe ShBA-së dhe pak për shkak të nevojave pragmatike për mbështetje ekonomike kombëtare dhe investime rajonale, pothuajse të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor shprehen në favor të dialogut ndërfqinjësor, pra për zgjidhje politiko-diplomatike të të gjithë problemeve ndërmjet tyre.

Është paradoksi ballkanik i radhës: mungesë dialogu të brendshëm, nxitje të dialogut fqinjësor. Pa dyshim dy standarde përjashtuese. Dy standarde hipokrite. Dy standarde antidemokratike. Dy standarde pragmatiste vulgare. Dy standarde mohuese të njëra-tjetrës. Në fund të fundit, dy standarde bllokuese, që pengojnë si zhvillimet demokratike të brendshme të secilit vend, po ashtu edhe zhvillimet rajonale të të gjithëve së bashku.

Mirëpo kësaj politike me dy standarde tanimë po i del boja. Demokracia, herët a vonë, e zhvesh hipokrizinë. Nevoja për dialog po ngrihet mbi konjukturat ditore si një vlerë afatgjatë. Dialogu është tipar i demokracisë, vlerë e shoqërive demokratike, karakteristikë e politikave publike, të shtrira në mënyrë koherente brenda dhe jashtë vendi. Pa paqe demokratike të brendshme nuk mund të ketë paqe demokratike fqinjësore. Për rrjedhojë, pa dialog demokratik, konstruktiv dhe permanent të brendshëm nuk ka dhe nuk mund të ketë dialog demokratik, konstruktiv dhe të suksesshëm fqinjësor.

# Narkoza e vizave - mit apo realitet (12)



Shkruan: Agron HOTI

## Kah po shkojmë

Ngathtësia e BE-së për ta shtyrë përpara procesin e liberalizimit të vizave për Kosovën dëshmon për vështirësitë me të cilat është duke u përballur në mbajtjen gjallë të perspektivës evropiane për rajonin tonë. Tashmë ka filluar të nuhatet se politikat e zgjerimit, të bazuara në kushtëzime të rënda janë duke sjellë vonesa të pafundme në procesin e integrimit evropian, ashtu sikundër që janë duke u treguar si instrument politik në zvenittje e sipër. Kjo ngathtësi e BE-së ka gjetur terren edhe si rezultat i zhvendosjes së fokusit gjeostrategjik të ShBA-së në zona të tjera të botës.

Historikisht vendet e Ballkanit Perëndimor kanë qenë trampolinë interesash lindore dhe perëndimore. Duke qenë kështu, çdo zbrazëtirë e krijuar nga njëri krah, tentohet të mbulohet nga krahu tjetër. E ngathtësinë e perëndimit në Ballkanin Perëndimor janë duke u munduar ta shfrytëzojnë me çdo kusht vendet lindore si Rusia, Kina, Turqia dhe Shtetet e Gjirit të Golfit (Arabia Saudite, Katari, Emiratet e Bashkuara Arabe dhe Kuvajti). Sigurisht që këto vende për të rritur ndikimin e tyre politik, ekonomik dhe kulturor në rajonin tonë janë duke shfrytëzuar resurse, qëllime dhe interesa të ndryshme.

Edhe pse mbi 70 % e tregtisë së jashtme të Ballkanit Perëndimor bëhet me BE, edhe pse tërë rajoni gëzon lëvizjen e lirë në hapësirën e Schengenit, me përjashtim të Kosovës, edhe pse tërë rajoni është duke punuar për t'u anëtarësuar në BE, nuk mund të anashkalohet fakti që reformat e ngadalta dhe pa masa të forta nxitëse të BE-së - pra investime - kanë filluar të ulin pritjet e qytetarëve të rajonit drejt BE-së, duke përjashtuar këtu qytetarët e Kosovës, të cilët edhe pse ende të izoluar vazhdojnë të shpërfaqin mbështetjen më të madhe në rajon për projektin evropian.

Përkundër izolimit Kosova vazhdon dhe do të vazhdojë të rrisë shkëmbimet tregtare me vendet e BE-së. Katër nga pesë investitorët kryesorë në Kosovë janë nga BE. Gjermania prinë me investime e ndjekur nga Zvicra, Austria dhe Mbretëria e Bashkuar, ndërkohë që Turqia zë vendin e pestë.

Pra, edhe pse ka zëra se Kosova po dominohet nga investimet turke, kjo në fakt nuk qëndron as për së afërmi. Edhe Turqia, pa marrë parasysh interesat e saj, nga Kosova shihet si partnere zhvillimore, ashtu siç vazhdon të shihet e tillë edhe nga të gjitha vendet e rajonit. Dhe nëse të gjitha vendet e rajonit të Ballkanit, përfshirë edhe Greqinë jo fort mike e shohin Turqinë si partner zhvillimor, atëherë Kosova, duke mos harruar se Turqia ka qenë pushtues i tmerrshëm për mbi 500 vjet, në aspektin e bashkëpunimit me këtë shtet nuk mund të jetë më ndryshe se sa vendet e rajonit dhe BE. Madje, BE për të rritur shkëmbimet tregtare me Turqinë ka ngritur Union Doganor, diçka që nuk e ka bërë me askënd tjetër në botë.

## Siguria

Në aspektin e sigurisë Mali i Zi, Kroacia, Sllovenia, Bullgaria, Rumania, Shqipëria janë anëtare të NATO-s dhe të gjitha, përkundër influencës ruse, kanë orientim perëndimor, përderisa Maqedonia deri me tani qe bllokuar nga vetoja greke, por me ndryshimet kushtetuese do zhbllokohet, Bosnja dhe Hercegovina është bllokuar nga Republika Srbska, Kosova vazhdon të ketë prezencë ushtarake të KFOR-it, ndryshimet legjislative të fundit hapën rrugë për krijimin e Forcave të Armatosura dhe gjithsesi që është tërësisht e orientuar kah aleanca veri-atlantike, Serbia merr pjesë në Programin e NATO-s "Partneriteti për Paqe", por mban lidhje të forta me Rusinë, kjo e fundit ka hapur Qendrën për Hulumtime në Nish të Serbisë që është vetëm 100 km nga kufiri i Kosovës, si kundërbalancë ndaj NATO-s në Kosovë. Kosova dhe rajoni i Ballkanit Perëndimor ka filluar me reforma në shkallë të gjerë, mirëpo niveli i ultë i zhvillimit ekonomik është duke tejngadalësuar reformat. Prandaj, BE duhet të ketë nxjerrë mësime deri me tani, pra duhet përgatitur sa më shpejtë që të jetë e mundur një Plan Marshall, i cili do të përshpejtonte zhvillimin ekonomik dhe reformat në rajon. Procesi i integrimit evropian i mbështetur nga Procesi i Berlinit, përpos që duhet të jenë plotësues ndaj njëri tjetrit, duhet të jenë më të shpejtë në veprime dhe duhet të rrisin investimet, e sidomos ato në infrastrukturë, e cila vazhdon të jetë e pazhvilluar dhe jokonkurruese.

## Korrupsioni dhe krimi i organizuar, fajtorë për çdo gjë

Pa dashur të mohohet fare korrupsioni dhe krimi i organizuar në Kosovë e vende të rajonit, sepse fundja këtë e thonë edhe raportet ndërkombëtare dhe përcepsioni qytetar në Kosovë, BE-ja duhet pasur parasysh që Kosova e rajoni nuk mbetën më të varfrat në Evropë si rezultat i korrupsionit dhe krimit të organizuar, por për një milion arsye tjera historike që të gjithë i dimë. Afrika nuk mbeti më e varfra në botë si rezultat i korrupsionit, por për miliona arsye tjera që dihen, Amerika Latine nuk mbeti më e varfra në Kontinentin Amerikan si rezultat i korrupsionit por për arsye që dihen, me një fjalë Hemisfera Jugore karshi asaj Veriore nuk mbeti e varfër për shkak të korrupsionit dhe krimit të organizuar, por për shkak të arsyeve që botërisht dhe që sot kanë marrë vëmendjen kryesore të studiuesve të marrëdhënieve ndërkombëtare.

Sot bota është e mbërthyer keq brenda interesave të shteteve, organizatave e mekanizmave ndërkombëtarë dhe kjo e shpjegon shumë mirë faktin që luftërat kurrë nuk bëhen në shkretëtira apo në maje të akullta të Andeve, Alpeve apo Himalajeve, por ato bëhen aty ku ka jetë e resurse, e aty ku ka jetë e resurse interesat historikisht mbizotërojnë.

Mos të pret dikush që rajoni i Ballkanit Perëndimor të lulëzojë ekonomikisht, kur dihet që ky rajon së paku në 300 vjetët e fundit gjithmonë ka qenë pjesa më e varfër e Evropës, Dhe nëse thuhet që korrupsioni dhe krimi i organizuar janë fajtorë për këtë gjendje, atëherë ai apo ajo ka humbur busullën në kohë dhe hapësirë.

Vetë praktika ka treguar që masat nxitëse përshpejtojnë zhvillimin ekonomik. Nuk u zhvillua rastësisht Koreja Jugore dhe nuk ngeci rastësisht ajo Veriore. Ishin masatnxitëse amerikane ato që e futën në konkurrencën globale jo vetëm Korenë Jugore, por edhe Tajvanin, Japoninë, Gjermaninë, e bashkë me të tërë Evropën Perëndimore. Po të mos ishte mbështetja amerikane, bota sot sigurisht që do të ishte nën një kombinatorikë krejtësisht tjetër me premisa ndoshta fatale për rajone të caktuara.

Dhe tash të kthehemi te Kosova. Nëse Kosova u çlirua nga mbështetja e madhe amerikane, zhvillimi ekonomik i mbetet pjesës evropiane. E nëse Evropa ishte mbështetur nga amerikanët për të ri-marrë veten pas Luftës së Dytë Botërore, atëherë njëjtë duhet vepruar në Kosovë dhe tërë rajonin e Ballkanit.

BE duhet të shuajë percepcionin se nuk po investon në Ballkan, sepse një zhvillim i hovshëm ekonomik në një Ballkan me mbi 50 milion banorë do t'u bënte konkurrencë të theksuar firmave eksportuese të BE-së, ashtu siç edhe do të rrudhte tregjet. Dhe nëse marrim parasysh garën e tmerrshme globale për qasje në tregje, atëherë ky përcepsion mund të duket i vërtetë.

Por, nëse qëllimi është që të ruhen tregjet dhe të mos rritet konkurrenca në Ballkan, pra që ekonomia e Ballkanit mos ta merr veten sa dhe si duhet, atëherë kjo nuk duhet maskuar duke thënë që është korrupsioni ai i cili po i pengon investimet në Kosovë e Ballkan, derisa në Kinë e Indi as që përmenden këto dukuri, së paku jo në përmasat me të cilat kritikohet Kosova dhe rajoni.

Po të ishte korrupsioni dhe krimi i organizuar në masën që thuhet, atëherë pyetja që shtrohet është se pse vende të caktuara të BE-së po investojnë në Kosovë?! Nëse korrupsioni është pengesë, atëherë ky mesazh duhet përçuar qartë dhe me masa sanksionuese, në mënyrë që qytetarët e Kosovës të votojnë elita tjera të pakorruptuara. **(Vijon)**



## Boltoni kërkon garanci nga Ankaraja për tërheqjen nga Siria

UASHINGTON, 8 JANAR - Këshilltari i presidentit për Sigurinë Kombëtare, John Bolton u tha aleatëve në Lindjen e Mesme se administrata e presidentit Trump nuk do t'i tërheqë forcat amerikane nga Siria Veriore deri kur Turqia të japë garanci se nuk do t'i godasë forcat kurde, të mbështetura nga Shtetet e Bashkuara dhe deri kur mbetjet e fundit të Shtetit Islamik të jenë mposhtur. Boltoni e bëri këtë deklaratë disa javë pasi presidenti Trump kishte njoftuar se do të tërhiqte tani trupat amerikane nga Siria.
Në mes të konfuzionit për tërheqjen e trupave amerikane nga Siria, presidenti Trump shfrytëzoi twitterin për të sulmuar njoftimet në media se ai ka ndryshuar mendje nga deklarata e dhjetorit për tërheqjen e menjëhershme të trupave dhe tani thotë se do të realizohet një tërheqje me ritmet e duhura.
Presidenti e postoi komentin ndërkohë që Këshilltari për Sigurinë Kombëtare, John Bolton po zhvillonte një vizitë katërditore në Izrael dhe Turqi.
Të dielën Boltoni siguroi kryeministrin izraelit Benjamin Netanyahu se nuk do të ketë tërheqje të nxituar nga Siria. "Do të diskutojmë vendimin e presidentit për t'u tërhequr, por kjo tërheqje nga Siria Verilindore do të realizohet në një mënyrë që garanton se ISIS është mposhtur dhe nuk do të jetë në gjendje të përbëjë përsëri kërcënim", tha ai.
Ish-zyrtari kurd Idris Naasan tha se luftëtarët kurdë në Siri si dhe aleatët e tjerë të Amerikës ndjehen më të qetë, pasi fillimisht u gjendën të papërgatitur nga komenti i presidentit Trump në dhjetor për një tërheqje të menjëhershme të forcave amerikane nga Siria. "Në mesin e kurdëve sheh një farë çlirimi, pasi Trumpi tha në deklaratën e fundit se nuk do të ketë tërheqje të menjëhershme nga Siria të të gjitha forcave amerikane", tha ai.
Gjatë bisedimeve të martën me presidentin turk Recep Tayyip Erdogan, Bolton pritet t'i kërkojë presidentit turk të garantojë se forcat e tij nuk do të godasin njësitë kurde, të cilat kanë luftuar përkrah Shteteve të Bashkuara kundër Shtetit Islamik. Sekretari i Shtetit Mike Pompeo, i cili do të zhvillojë një vizitë një javore në Lindjen e Mesme, pritet të sigurojë aleatët se Shtetet e Bashkuara nuk do ta braktisin këtë rajon.


AP

# Kriza rreth murit në ShBA

Për të fituar mbështetje për ndërtimin e një muri kufitar, administrata e presidentit të ShBA-së, Donald Trump, po përpiqet ta paraqesë kufirin jugor me Meksikën si një krizë humanitare dhe kombëtare të sigurisë

UASHINGTON, 8 JANAR - Administrata e presidentit të Shteteve të Bashkuara, Donald Trump, po përpiqet ta paraqesë kufirin jugor me Meksikën si një "krizë humanitare dhe kombëtare të sigurisë", për të fituar mbështetje për ndërtimin e një muri kufitar. Mospajtimet me ligjvënësit demokratë për këtë çështje kanë çuar në mbylljen e pjesshme të Qeverisë amerikane, gati që tri javë.
Trumpi do t'i adresohet të martën kombit për këtë çështje, ndërsa të enjten do të udhëtojë në kufi. Përpara fjalimit, nënpresidenti amerikan Mike Pence tha për gazetarët se në kufi ekziston një krizë dhe i fajësoi demokratët për refuzimin e negociatave për ta rihapur qeverinë.
Pences iu bashkua sekretarja për siguri kombëtare, Kirstjen Nielsen, e cila tha se status quoja e financimit dhe ligjeve "nuk po arrin ta trajtojë krizën në kufi". Demokratët dhe mbështetësit e migrimit thonë se mënyra se si administrata e paraqet çështjen është "e pasaktë" dhe e akuzojnë atë për prodhim të krizës për çështje politike.
Kryetarja e Dhomës së Përfaqësuesve, Nancy Pelosi, dhe udhëheqësi i pakicës demokrate në Senat, Chuck Schumer, lëshuan një deklaratë të përbashkët, duke iu bërë thirrje rrjeteve televizive t'iu japin demokratëve shans për t'iu përgjigjur fjalimit të Trumpit, duke thënë se historia sugjeron se fjalimi i tij do të jetë plot keqdashje dhe keqinformim.
Ata gjithashtu thanë se presidenti duhet ta pranojë se plani i tij për murin nuk ka mbështetje të mjaftueshme në Kongres. "Demokratët dhe një numër në rritje i republikanëve në Kongres i kanë bërë vazhdimisht thirrje presidentit dhe udhëheqësit të Senatit, Mitch McConnell, të rihapin qeverinë, derisa Kongresi debaton për murin e shtrenjtë dhe joefektiv të presidentit", thanë Pelosi dhe Schumer.
Gjatë dy javëve të fundit, udhëheqësit demokratë kanë vizituar Shtëpinë e Bardhë dy herë, për të negociuar një marrëveshje me presidentin dhe kanë dështuar.
Shtëpia e Bardhë po shqyrton ligjshmërinë e shpalljes së një emergjence kombëtare në kufi, për të nisur ndërtimin e murit pa miratimin e Kongresit. Në konferencën e tyre për media, Pence dhe Trump vazhduan ta peshojnë idenë.
Mbyllja e pjesshme e qeverisë ka ndërprerë një të katërtën e operacioneve të Qeverisë amerikane qysh më 22 dhjetor dhe ka detyruar rreth 800,000 punonjës federalë të shkojnë në pushim ose të punojnë pa pagesë.
Pence tha se administrata e kupton barrën me të cilën përballen punonjësit e qeverisë. Përveç 5.6 miliardë dollarëve për murin, administrata kërkon edhe 800 milionë dollarë për nevojat urgjente humanitare për t'u kujdesur për migrantët në kufi. Demokratët, duke refuzuar kërkesën e Trumpit për financimin e murit, kanë ofruar 1.3 miliard dollarë shtesë në shpenzimet për sigurinë e kufirit.



## Kim Jong Unin viziton Kinën

PJONG JANG, 8 JANAR - Udhëheqësi i Koresë së Veriut, Kim Jong Un, gjendet në Kinë për katër ditë bisedime me presidentin kinez Xi Jinping. Ftesa është bërë nga vetë presidenti kinez. Ndërkohë, presidenti amerikan Donald Trump ka njoftuar për mundësinë e një samiti të dytë me udhëheqësin koreanoverior.
Të martën në mëngjes mbërriti në Pekin një tren i posaçëm. Në bord ndodheshin Kim Jong Uni dhe bashkëshortja e tij Ri Sol Ju, si dhe grup zyrtarësh të lartë koreano-veriorë. Agjencia zyrtare e lajmeve të Koresë së Veriut tha se Kimi ndodhet në kryeqytetin kinez me ftesë të presidentit Xi.
Që nga viti i kaluar, kjo është vizita e katërt e Kim Jong Unit në Kinë, aleatja kryesore ekonomike dhe diplomatike e Koresë së Veriut. Ndërkohë, presidenti amerikan Donald Trump tha se po zhvillohen negociata për zhvillimin e një samiti të dytë. "Po negociojmë për vendndodhjen. Ndoshta do të njoftohet në një të ardhme jo shumë të largët. E kanë bërë të qartë edhe nëpërmjet medias se duan të takohen. Edhe ne duam të takohemi, kështu që do të shohim ç'do të ndodhë. Sidoqoftë, sanksionet mbeten plotësisht në fuqi dhe do të vazhdojnë kështu derisa të kemi prova", tha Donald Trump.



Dhuna seksuale nga forcat ushtarake serbe ndaj grave shqiptare gjatë luftës në Kosovë (3)

# Krimi i dhunës seksuale është krim kundër njerëzimit



Elife LUZHA

**- Pushtimi i Kosovës dhe represioni serb mbi shqiptarët etnikë**

"Krimet e kryera në Kosovë kanë qenë plotësisht nën kontrollin e strukturave politike, ushtarake dhe policore serbe, që synonin shkatërrimin e shqiptarëve si të tillë dhe ndryshimin e strukturës së popullsisë së Kosovës, thotë politologu Bardhyl Mahmuti (Mahmuti, 2015:291), ndaj kjo ishte edhe arsyeja e themelimit të Tribunalit Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë, me qëllim dënimin e përgjegjësve të krimit të kryer.
Pas themelimit të Tribunalit në Nurnberg më 1945, për dënimin e përgjegjësve të Holokaustit për krime lufte të kryera gjatë Luftës së Dytë Botërore dhe Tribunalit të Tokios më 1946, bota pak kishte besuar se do të rikthehej koha e rithemelimit të tribunaleve të ngjashme për dënimin e krimeve të luftës, si Tribunali për ish-Jugosllavinë në Hagë dhe Tribunali për Ruandën, më vonë edhe Tribunalin për Siera Leonen.
"Tribunali i Hagës u themelua pas shthurjes së Federatës Jugosllave më 1991 dhe shkeljeve flagrante të ligjit ndërkombëtar, duke përfshirë vrasjet masive, përdhunimet sistematike e krimet e tjera çnjerëzore" (www.academia.edu).
"Tribunali Penal Ndërkombëtar (TPNJ) përdhunimin gjatë kohës së luftës e definoi si veprim të torturës dhe skllavërisë seksuale, si krim ndaj njerëzimit, që konsiderohet arritje e jashtëzakonshme në luftën kundër mosndëshkimit të kriminelëve të luftës" (kosovotwopointzero.com).
Megjithatë, ky tribunal është ndeshur me kritika të ashpra për mosdënimin e kriminelëve, e sidomos të krimeve të dhunës seksuale. Fondi për të Drejta Humanitare (FDH) kritikon Tribunalin për një numër të vogël të akuzave për krimet ndaj civilëve në Kosovë. Madje sipas FDH-së, në disa raste "gjykimet janë shumë të buta dhe me shumë favore për të dënuarit".
Po rikujtoj se, për të plotësuar sistemet penale kombëtare, më 1995 u krijua Gjykata Ndërkombëtare Penale e Përhershme,"e cila dhunimin e cilësoi si formë gjenocidi" (Mahmuti, 2015:292). Kurse po e "njëjta gjykatë për Kroacinë, Bosnjën dhe Kosovën deklaroi se nuk ka pasur gjenocid" (Mahmuti, 2015:295).
Janë të papranueshme këto anësime të gjykatave respektive, në një kohë kur një numër i konsiderueshëm i organizatave kombëtare e ndërkombëtare tanimë kanë publikuar një varg raportesh, përmes të cilave japin të dhëna për krimet seksuale nga forcat serbe ndaj 20000 grave shqiptare të dhunuara në Kosovë, në shërbim të spastrimit etnik.
E për ta dëshmuar këtë që po them, do të përmend vetëm disa nga këto organizata, si: Organizata e Kombeve të Bashkuara, Amnesty International; Organizata Botërore e Shëndetësisë, Human Rights Watch, World Health Organization, US-based Centreof Diseaseetj., që kanë publikuar edhe në internet me mijëra faqe të krimit të dhunës seksuale nga forcat serbe ndaj 20000 grave shqiptare në Kosovë.
Konventa e Gjenevës për Mbrojtjen e Personave Civilë në Kohë Lufte, në nenin 27 të saj shpreh qartë të drejtën e grave për t'u mbrojtur kundër çdo shkeljeje të nderit të tyre, dhe sidomos kundër dhunimit, por edhe kundër çdo akti fyes. Forcat ushtarake serbe gjatë luftës në Kosovë aplikuan dhunën seksuale si mjet lufte duke shkelur jo vetëm nenin 27 të Konventës së Gjenevës, por edhe "nenin 7 të Statutit të Romës, ku specifikohet qartë se përdhunimi, si dhe çdo formë tjetër e dhunës seksuale që përdoren si pjesë e një sulmi të gjerë ose sistematik drejtuar kundër cilësdo popullsi civile,është krim kundër njerëzimit. Në anën tjetër, sipas nenit 6 të Statusit të Romës,shkaktimi i dëmeve të rënda trupore ose mendore anëtarëve të grupit,me qëllim që të shkatërrojë, në tërësi ose pjesërisht, një grup kombëtar, etnik, racial apo fetar përbën akt të gjenocidit" (www.academia.edu).
Aplikimi i dhunës seksuale si mjet lufte nga forcat ushtarake serbe në Kosovë, në shërbim të spastrimit etnik, ishte akti më brutal i gjenocidit serb në historinë më të re të kontinentit tonë. Serbia edhe pas 20 vjetësh të përfundimit të luftës, nuk ka kërkuar falje për krimet e kryera në Kosovë e as i ka dënuar ato. Por, siç thuhet, "historia është kryeneçe", kurse "krimet e luftës nuk vjetrohen kurrë".
E drejta ndërkombëtare nuk u zbatua edhe në rastin e Kosovës Filozofi francez i së drejtës së shtetit, Monteskje (Montesquieu),dyqind vjet më parë thoshte: "Në paqe duhet të ndihmojmë sa më shumë njërijtetrit. Kurse në luftë duhet të kujdesemi të bëjmë sa më pak të këqija".
Natyrisht, gjenialiteti i Monteskjesë në këtë rast nuk e kishte në mendje barbaro-gjenjun serb, që në emër të luftës bën krime, e në emër të paqes abuzon. Krimet e forcave ushtarake policore serbe në Kosovë kundër popullsisë civile, (vrasjet, burgosjet, gjymtimet, keqtrajtimet, dhunimet në masë, deportimet) që nga Millosh Obrenoviqi e deri te Sllobodan Milloheviqi, ende nuk i ka të dëgjuara historia më e re e kontinentit tonë. Në Beograd, serbët shpërthejnë shampanja kur marrin vesh mizoritë e shkaktuara nga trupat e tyre. "Ky është qëndrim kafshëror e shtazarak. Kur të mund të shfaqen provat për krimet serbe në Kosovë, Perëndimi do të tmerrohet", thotë shkrimtari ynë I. Kadare, në një intervistë dhënë gazetarit Alan Bosquet.
Vitet e fundit, e drejta ndërkombëtare është zhvilluar mjaft në drejtim të kërkimit të përgjegjësive më të mëdha për krimet e dhunës seksuale, kur kryhen me qëllim që të shkatërrojnë një grup etnik, nacional apo racor në tërësi ose pjesërisht, që pretendohet se po aplikohen si mjet bashkëkohor i luftës.
Forcat ushtarake policore serbe gjatë luftërave të zhvilluara kundër republikave ish-Jugosllave më 1991-1999, në Bosnjë e Kroaci, më vonë edhe në Kosovë, "dhunimet seksuale i aplikuan si mjete bashkëkohore të luftës dhe synonin shkaktimin e dëmeve të pariparueshme ndaj anëtarëve të grupit", thotë politologu Bardhyl Mahmuti (Mahmuti, 2015:292).
Gjykata Penale Ndërkombëtare për Ruandën e cilësoi dhunimin si formë e gjenocidit, gjë që nuk ndodhi edhe për Kosovën e Bosnjën.
Edhe në Siera Leone, Gjykata Speciale dhunimin dhe format e tjera të dhunës seksuale i ka ndjekur penalisht si akte gjenocidi, kur kryhen me qëllim që të shkatërrojnë një grup etnik, fetar, nacional apo racor në tërësi ose pjesërisht.
Në Bosnjë, gjatë agresionit serb më 1991, siç thotë gazetari Denis Dzidic, "forcat ushtarake policore kishin dhunuar seksualisht 50000 gra, por vetëm 30 autorë krimesh të drejtpërdrejta janë dënuar nga gjykatat vendore dhe Gjykata Ndërkombëtare për Krime në ish-Jugosllavi. Ai thotë gjithashtu, se çështja e përdhunimit të grave në Bosnjë mori përmasa ndërkombëtare, sidomos nga kontributi i regjisores së njohur Angelina Jolie me filmin "Në tokën e gjakut dhe të mjaltit" (www.balkaninsight.com).
Në këtë drejtim, kontributi të madh ka dhënë edhe Qeveria e Britanisë, në krye me kryeministrin William Hague, i cili, për shkak të numrit të madh të krimeve të pandëshkuara të dhunës seksuale gjatë luftës në Bosnjë, kishte krijuar një ekip hetuesish për ta gjykuar dhunën seksuale. Në ekip bënin pjesë oficerë policie, avokatë, psikologë dhe ekspertë të mjekësisë ligjore, të cilët ishin udhëzuar që të mblidhnin prova për dhunën seksuale në masë sepse, siç ishte shprehur z. Hague, duhen siguruar të drejta të barabarta për gratë në çdo nivel të shoqërisë dhe duhen mbrojtur të pambrojturit (po aty).
Gazetari Dzidic njofton, gjithashtu, se prej 161 të padituve, Tribunali i Hagës ka dënuar vetëm78 persona për krime seksuale. Kurse gjykata në Bosnjë-Hercegovinë ka pasur rreth 20 gjyqe për të paditur të akuzuarit për krime seksuale (po aty). Ndërsa Amnesty International për krime të dhunës seksuale në Bosnjë thotë se janë dënuar 134 persona (https://www.amnesty.org).

(Vijon)



E jashtëzakonshme

# "Fshati" i minjve



Të ballafaquar me një familje minjsh që drejtohen për në kopshtin tuaj, shumë prej nesh do të vinin kurthe. Por, fotografi i jetës së egër, Simon Dell, megjithatë, pa një mundësi. Me shpresën e gjetjes së disa fotografive të mrekullueshme, ai vendosi të krijonte një fshat në miniaturë për brejtësit e vegjël. Dell krijoi një shtëpi të veçantë dhe shesh lojërash për minjtë, të cilët ai i ka quajtur Xhorxh dhe Mildred, dhe fëmija i tyre, Mini. Krijesat e vogla hanë manaferra dhe arra.

FOTO E DITES




Një grua dhe djali i saj përplasen nga valët e detit në Bejrut të Libanit. /AP/

E rrallë

# Tradita për ndalimin e acarit të dimrit në Japoni



Capybara është një gjitar i lindur në Amerikën e Jugut dhe është brejtësi më i madh në botë i cili ngjan kryesisht me derrat gjigantë. Ai kalon shumicën e kohës në ujë. Disa ditë më parë disa video të këtyre kafshëve qesharake (hydrochaeris) po qarkullojnë në rrjete sociale, duke u zhytur në një vaskë të mbushur me ujë të nxehtë dhe plot yuzu (portokaj japonezë). Çdo vit, për acarin e dimrit, kujdestarët e kopshteve të ndryshme zoologjike në Japoni zhytin capybara në këto pishina.

## BARSOLETA E DITËS



**Mësuesja: Beni, cili është presidenti i ShBA-së?**
**Beni: Nuk e di, mësuese.**
**Mësuesja: Beni, duhet të kujdesesh më shumë për mësimet.**
**Beni: Po ti mësuese, e di cila është Maria?**
**Mësuesja: Jo.**
**Beni: Duhet të kujdesesh më shumë për burrin tënd.**

KINO ABC PRISHTINE

## Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Në ora 16:00

### "THE GRINCH" 3D,



I Animuar/Komedi/Familjar; 1 ore 30 min

Rolet: Benedict Cumberbatch, Rashida Jones, Kenan Thompson, Cameron Seely, Angela Lansbury, etj.

Regjia: Scott Mosier, Yarrow Cheney



Në ora 17:30

### "THE NUTCRACKER AND THE FOUR REALMS" 3D

Aventure/Fantazi/Familjar; 1 ore 39 min

Rolet: Keira Knightley, Mackenzie Foy, Eugenio Derbez, Mathew Macfayden, Helen Mirren, Morgan Freeman, etj.

Regjia: Lasse Hallstrom, Joe Johnston

Në ora 19:30

### "MORTAL ENGINES" 3D,




Komedi; 1 ore 51 min

Rolet: Hugo Weaving, Hera Hilmar, Robert Sheehan, Jihae, Ronan Raftery, Leila George, Patrick Malahide, Stephen Lang, etj.

Regjia: Christian Rivers




Në ora 22:00

### "HUNTER KILLER",

Aksion/Aventure/Fantazi; 2 ore 08 min

Rolet: Gerard Butler, Gary Oldman, Common, Linda Cardellini, Toby Stephens, Michael Nyqvist, Caroline Goodall, etj.

Regjia: Donovan Marsh

**Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.**



**DASHI**
Dita do të ketë mjaft lëvizshmëri sa në një moment të caktuar do t'i harroni prioritetet tuaja. Një familjar do të mërzitet nga kjo neglizhencë.



**DEMI**
Një situatë e komplikuar mes kolegësh sot do të marrë një drejtim tjetër. Nëse rrezikoni bashkëpunimin në fund do t'ju fajësojnë juve.



**BINJAKËT**
Sot duhet të thoni një fjalë të mirë për një person që ju e njihni mjaft mirë dhe që sot do ta kërkojë ndihmën tuaj.



**GAFORRJA**
Nuk do të mund të realizoni sot objektivat tuaja nëse nuk e ndani që në mëngjes programin e ditës. Çdo e papritur penalizon finalizimin e punës.



**LUANI**
Një gënjeshtër që ju kanë thënë do të vazhdojë të thellohet më shumë. Kujdes me personat që mbani pranë vetes.



**VIRGJËRESHA**
Raportet personale nuk duhet të ndikojnë në ato profesionale sepse do ta prishni punën tuaj. Një çështje delikate ka zënë ditën tuaj sot.



**PESHORJA**
Surpriza për ditën e sotme do të jetë takimi me një mik që kishit kohë pa e parë. Do të shikoni që koha ka ndaluar dhe këshillat e tij janë gjithmonë të vlefshme.



**AKREPI**
Keni limitet tuaja në fusha të caktuara dhe do të jetë mirë ta pranoni këtë gjë. Nuk ka asnjë problem nëse kërkoni ndihmë kur e shihni të nevojshme.



**SHIGJETARI**
I keni zgjedhur mjaft mirë kundërshtarët tuaj dhe do të arrini t'i manipuloni deri në momentin që e quani të arsyeshme.



**BRICJAPI**
Po keqkuptoni afrimin e dikujt sot dhe do t'ju duket sikur ka ide të tjera nga ato që ju ka shprehur. Do ta kuptoni me kohë se keni gabuar.



**UJORI**
Herë pas here keni brejtje ndërgjegjeje për veprimet që keni bërë në të kaluarën. Keni kohë për t'i rregulluar situatat nëse i përvisheni punës.



**PESHQIT**
Keni marrë përsipër shumë aktivitete njëherësh. Nuk do të përfundoni asnjërën prej tyre sepse ngarkesa do të jetë e madhe.

# Dick Wolf ndahet nga gruaja pas 12 vjetësh martesë



Dick Wolf dhe gruaja e tij Noelle po ndahen zyrtarisht. 72-vjeçari paraqiti dokumentet për divorc më 3 dhjetor të vitit që kemi lënë pas, ka raportuar "TMZ". Noelle raportohet se ka kërkuar ndarje ligjore dhe mbështetje bashkëshortore. Të dy ishin të martuar për 12 vjet dhe kanë dy fëmijë së bashku. Kjo ishte martesa e tretë e Dickit.




# Jim Carrey në lidhje me Ginger Gonzaga

Duket se Jim Carrey nuk është më në mesin e beqarëve. Aktori 56-vjeçar është në lidhje me kolegen e vet nga Kidding, Ginger Gonzaga. Kështu kanë deklaruar disa burime pranë tyre. Duket se krejt kjo është konfirmuar kur të dy janë parë bashkë në ndarjen e çmimeve Golden Globes në Los Angeles, duke e bërë kështu edhe debutimin e tyre si çift, në tapetin e kuq.

# Angelina Jolie del për pazar me djalin e vogël



Aktorja amerikane po shijon ditët me fëmijët. Angelina Jolie u pa duke bërë pazar me djalin e saj të vogël 10-vjeçar, Knox. Mirëpo 43-vjeçarja u nis drejt shitoreve ushqimore e veshur elegante me një fustan të bardhë, pallto dhe këpucë me take, jo të përshtatshme për të bërë pazar. Ajo jeton me gjashtë fëmijët e saj, edhe pse është në një betejë me ish-burrin e saj, Brad Pitt, se cili t'i marrë fëmijët.

# Aktori Kevin Spacey paraqitet në gjykatë



Aktori Kevin Spacey është paraqitur në gjykatë për t'u përballur me një akuzë të pahijshme për sulm seksual. Fituesi i Oskarit po akuzohet për sulm seksual ndaj një djali 18-vjeçar, pasi e dehi atë me alkool në një bar në Nantucket më 2016. Ai po përballet me sulme seksuale edhe në Londër dhe Los Anxhelos.

INTERVISTË ME AKADEMIK MEHMET KRAJËN (4)

# SHKATËRRIMI INSTITUCIONAL

**Jetoni në kryeqytetin e Kosovës, në të cilin, më shumë se në cilindo qytet të saj, promovohet disi kultura dhe, po ashtu, disi arsimi dhe shkenca. Si ju duket veprimtaria kulturore, arsimore dhe shkencore që zhvillohet përreth jush, në seminare ndërkombëtare që organizojnë fakultetet, në konferenca shkencore të instituteve dhe të akademive?**

E përmenda teatrin dhe ai është një episod, ndoshta më i pakëndshmi, por jo i vetmi. Në përgjithësi, institucionet tona kanë degraduar dhe nga dita në ditë bëhen gjithnjë e më keq. Shteti ndërtohet me institucione, këtë besoj se e kanë kuptuar të gjithë, ndërsa institucionet e kulturës, pavarësisht se nuk merren shumë në konsideratë, krijojnë identitetin e shtetit, dhe dinjitetin, natyrisht. Te ne, pas luftës, ndodhi një çrregullim i madh, një akulturim i tmerrshëm dhe një prirje vandaliste në institucionet e kulturës. Ne nuk arritëm të nisnim një lëvizje kulturore emancipuese, për të cilën kishim nevojë aq shumë, sepse kishim kaluar periudhën e rëndë të pushtimit dhe njerëzit, në përgjithësi, e kishin të domosdoshëm edukimin dhe emancipimin kulturor. Kjo nuk ndodhi. Tani vjelim pasojat. Me anë tjetër, gjatë periudhës së qeverisjes së ndërkombëtarëve, kultura kombëtare u konsiderua nacionaliste dhe me këtë frymë u edukua një gjeneratë e tërë e djemve dhe vajzave të UNMIK-ut, të cilët më pas morën në dorë OJQ-të dhe përgjithësisht të ashtuquajturën shoqëri civile. Ata volën fonde, duke kultivuar stereotipat e bashkim-vëllazërimit: bashkëjetesën midis komuniteteve, integrimin evropian si perde tymi për integrim në Serbi dhe mënjanimin kategorik të kulturës kombëtare. Tani UNMIK-u nuk është më, burimet e financimit janë shterë dhe shoqëria civile u është vërsulur institucioneve, përfshirë edhe ato të kulturës. Por ajo edukimin e ka marrë tek UNMIK-u. Ja një shembull si ka shkuar ky deformim, që sërish lidhet me teatrin: para disa vjetësh në Teatrin Kombëtar u zgjodh një bord, i cili, siç e thash, e quajti arritjen më të madhe mënjanimin e dramës origjinale nga skena. Ky bord bëri programin dhe në të përfshiu edhe "Tartufin" e Moilierit, me një regjisor rom nga Maqedonia. Fonde të konsiderueshme u morën nga Ministria e Kulturës dhe nga donatorë të ndryshëm, por shfaqja doli si "Koshtana" e Boro Stankoviqit. Në një tekst që shkrova me atë rast, unë e quajta ""Tartufi' i Vranjës". Regjisori rom i periferive të Shkupit e bëri shfaqjen sipas formatit të tij kulturor, por ajo që doli si rezultat final, ishte hyrja e sërishme djallëzore e teatrit serb në Teatrin Kombëtar të Kosovës. Unë e thash këtë publikisht dhe mora një "goditje të rëndë" nga shoqëria civile e Kosovës: më quajtën nacionalist racist dhe këputën edhe ca broçkulla të këtilla. Por ideatori i shfaqjes nga shoqëria civile, si me magji, u bë dramaturg i njohur, i financuar nga fondacione dhe OJQ me prapavijë krejtësisht joartistike dhe joteatrore. Tani, këta kalamaj të UNMIK-ut, të tillë që ka me shumicë në teatër, në artet figurative dhe në film, ndonjëherë edhe në letërsi, bredhin se nga bredhin dhe, kur u mbarohen paratë, kthehen në Kosovë që t'ia marrin komunitetit artistik edhe ato pak fonde që ua ndan buxheti i shtetit. Kjo ndodhi me Galerinë e Arteve, kur u rrënua një mur për të bërë një stallë dhe për të fyer një komunitet kulturor me një performancë krejtësisht joartistike. Ndërkohë, shkatërrimi institucional kulturor nuk ndalet. Në Bibliotekën Kombëtare të Kosovës shkatërrimi i fondeve të librit nga vjedhja sistematike dhe nga vërshimi i ujërave të zeza vazhdon që gati njëzet vjet. Në Institutin Albanologjik dhe në Institutin e Historisë shkencën e bëjnë njerëz të dëmshëm me padituritë e tyre për shkencën dhe kulturën e këtij vendi. Dy institutet më prestigjioze të Kosovës bëjnë abuzime të mëdha me shkencën, duke u bërë çerdhe politike për njerëz me anime të rënda partiake. Abuzimet shkencore shkojnë deri në atë shkallë sa Instituti i Historisë, ta zëmë, boton libër shkencor bullgarisht me Prishtinën si vend i botimit. Tani ku mbetet të bëhet shkencë? Në Seminarin Ndërkombëtar janë vënë radhë burra dhe gra, të cilët nuk lënë të afrohet askush: vetë i bëjnë programet, vetë promovohen, vetë shpallën shkencëtarë me njohje ndërkombëtare, por në gjuhësinë albanologjike nuk kanë as rezultate minimale. Më parë sesionet shkencore të Seminarit i ndiqja rregullisht dhe në ndonjë rast kam marrë pjesë edhe me kumtesa për tema të ndryshme nga fusha e letërsisë. Para nja pesë vjetësh shkova për të dëgjuar se çfarë thuhej tani në këto tubime shkencore, sepse temë ishte romani. Mbeta i çmeritur: një studiuese fliste për romanet e E. Dones, një koleg i saj për romanin "Gjuetari i balonave" si model i paarritshëm i letërsisë shqipe. U ngrita dhe dola, me një mendje që kurrë më mos të kthehesha në atë vend. Pra, në përgjithësi një gjendje e trishtë. Por, mendoj unë, kulmi i marrëzisë kulturore në Kosovë është zhvendosja e Ministrisë së Kulturës në Prizren, një veprim pa asnjë argument kulturor, vetëm pse dikush ka edukim kulturor të gabuar dhe pandeh se xhamitë, kishat, themelet e një kalaje dhe ndonjë urë e vjetër e bëjnë vetvetiu këtë qytet qendër kulturore të Kosovës. Prizreni mund të jetë i rëndësishëm për promovimin e turizmit kulturor dhe asgjë më shumë, sepse qyteti jo vetëm që nuk ka institucione, por nuk ka as audiencë kulturore. Mungesa e një reagimi të komunitetit kulturor, në shumë raste, bën që vendimmarrësit politikë të ndihen komodë në të gjitha marrëzitë e tyre.

### Një projekt i tillë do të duhej të nisej dhe të realizohej në Kosovë

**Një tekst për historinë e letërsisë shqiptare, prej fillimit të saj e deri më tash, ende na mungon. Kur duhet të shkruhet kjo histori letërsie?**

Letërsia shqipe, që të përfshihet në një histori, i ka të pazgjidhur dy probleme kryesore: ndarjet territoriale dhe ndarjet politike-ideologjike. Nëse do të shkruhej në Shqipëri kjo histori e letërsisë, letërsia e Kosovës e



MEHMET KRAJA

ka të sigurt se do të përfshihej në një formë të cunguar, sa nga mosnjohja, sa nga paternalizmi i ngulitur në atë anë të botës shqiptare. Pra, një projekt i tillë do të duhej të nisej dhe të realizohej në Kosovë, në të cilin, natyrisht, do të përfshiheshin edhe studiuesit e Shqipërisë. Por as në Kosovë nuk përballohen aq lehtë dallimet politike-ideologjike dhe të tjera, që kanë mes vete studiuesit tanë të letërsisë: janë problemet e metodës në rend të parë, por edhe të periodizimit. Disa vjet më parë, pas vitit 2000, në Akademi, kur unë ende nuk kam qenë anëtar, ishte mbledhur një grup iniciues për ta hartuar elaboratin e një projekti të historisë së letërsisë shqipe, por ata që e përbënin grupin nuk kishin arritur të merreshin vesh. Tani unë mendoj se, pa u tejkaluar një konflikt i filluar herët në fushën e studimeve letrare, nuk mund të bëhet gjë në këtë drejtim. Mendoj se duhet pritur edhe një kohë, por më vonë ekziston rreziku që mos të gjenden aq studiues seriozë të kësaj fushe të cilët do të mund t'i bënin ballë një projekti të këtillë.

### Disa nga shkrimtarët më në zë kishin mbështetës politikë

**Cila periudhë e letërsisë shqipe, cilët shkrimtarë dhe cilat vepra ju kanë lënë mbresa më të mëdha? Me këtë rast, me shkas po jua kujtojmë një shkrim që e patët botuar në gazetën "Express", në të cilin letërsinë shqipe e patët trajtuar ashpër dhe rreptë. Edhe disa shkrimtarë aty (Konicën dhe Nolin) i patët quajtur përçarës.**

Herë pas here kam bërë ndonjë shkrim për çështje të ndryshme rreth letërsisë shqipe, por nuk më kujtohet ta kem trajtuar atë me ashpërsi. E vërteta është se historia e letërsisë shqipe është histori glorifikimesh, histori mburrjesh dhe analizash pozitiviste. Historianët e letërsisë, ta zëmë, ua kanë dhënë hakun shkrimtarëve të letërsisë së vjetër, duke i quajtur veprat e tyre letërsi biblike, ose bejtexhinjve, por nuk janë bërë analiza serioze sa i përket letërsisë së Rilindjes dhe pas saj, ta zëmë, marrjet arbëreshe nga letërsia italiane, apo marrjet e Naimit nga letërsia perse, ose të Fishtës nga letërsia popullore. Edhe më të pakta janë analizat e marrëdhënieve të ndërvetshme të shkrimtarëve. Merreni vetëm një detaj: marrëdhëniet e Konicës me Apolinerin që te ne janë glorifikuar dhe u janë thurë lëvdata të marra, në një kohë që Konica nuk i përmend kurrë këto marrëdhënie. A thua, pse? Thjesht, sepse shkonin përtej miqësisë letrare. Ose marrëdhëniet e Konicës me Nolin ishin të tmerrshme, përçarëse dhe armiqësore deri në atë shkallë sa Konica, kur Noli kërkon ndihmë nga shteti shqiptar për mjekim, ai, në cilësinë e ambasadorit që jetonte në hotel dhe bënte jetë luksi, shprehet kundër ndihmës. Të mos harrohet se Konica, pas pushtimit italian të Shqipërisë, ia dorëzoi ambasadorit italian në Uashington vulat dhe kredencialet e ambasadës së vet, me marrëveshjen për t'ia shlyer borxhet. Pastaj marrëdhëniet e këtyre shkrimtarëve me pushtetet dhe ideologjitë janë shumë problematike, ndonjëherë marrëzisht të idealizuara. Si thoni ju, pse De Rada dhe arbëreshët e tjerë gëzuan mbështetjen e Italisë pa ndonjë prapavijë? Ata, për gati një shekull, ishin pararojë e interesave italiane në këtë anë të Adriatikut. Por, nga më joparimorët është Konica, ndërsa Noli, po e shikuat mirë, del prift komunist, i lidhur ngushtë me Kishën Ortodokse Ruse. Po Fishta dhe fashizmi? Ende më të ngatërruara dalin marrëdhëniet e Naimit dhe të Samiut me Perandorinë Otomane: që të dy ishin të besuar të shtetit, ndërsa Naimi ishte censor. Edhe marrëdhëniet e disa shkrimtarëve me pushtetin në kohën e Zogut dalin jashtëzakonisht "të papërshtatshme". Me anë tjetër, ne tani e lavdërojmë shpesh Ernest Koliqin për punën që ka bërë si ministër i Arsimit në kohën e fashizmit, me hapjen e shkollave në Kosovë, ndërsa harrojmë se ai këtë e bëri si ministër kuisling dhe se, po të jetë për punë shkollash, më shumë merita kanë ata që në kohën e ish-Jugosllavisë në Kosovë hapën Universitetin sesa ai që hapi ca shkolla fillore. Pra, dua të them se historia jonë e letërsisë ose nuk duhet të merret me detaje të biografive të shkrimtarëve ose, nëse merret, duhet t'i thotë të gjitha, pa idealizuar dhe pa glorifikuar asgjë. Kjo vlen edhe për letërsinë e Kosovës në periudhën e ish-Jugosllavisë. Shumica e shkrimtarëve tanë të kësaj periudhe del se ishin të angazhuar pozitivisht sa i përket çështjes kombëtare, por duhet ditur se midis tyre kishte shkrimtarë të mirë dhe shërbëtorë të pushtetit, siç kishte shkrimtarë të dobët dhe të përndjekur politikë. Disa nga shkrimtarët më në zë kishin mbështetës politikë, madje deri në shkallën e mecenëve. Unë nuk i kam harruar ngritjet e tyre si me levë në pushtet dhe në karrierë letrare. Ju të gjeneratës së re nuk e dini se kush bëhej drejtor tre mandate si askush tjetër në Jugosllavi me ndihmën e Fadil Hoxhës, kush merrte grada shkencore dhe punësohej në Universitet me ndihmën e Mahmut Bakallit, kush gëzonte status të privilegjuar në Institutin Albanologjik me mbështetjen e Ismajl Bajrës, dikush tjetër të Sinan Hasanit ose të Dushko Ristiqit, ca të tjerë bënin shkencën e historisë me mbështetjen e Ali Shukrsë, sekush zinte pozita në "Rilindje" ose në Universitet me ndihmën e Xhavit Nimanit, madje edhe të Rrahman Dedajt ose të Azem Vllasit, e kështu me radhë, shumica duke bërë jetë paralele dhe me dy morale: në njërën anë angazhime patriotike, në anën tjetër duke i shërbyer pushtetit dhe duke e shitur shpirtin për dy aspra. Ta zëmë, si bëhet që një i tillë që fuste njerëz në burg sa ishte në Radiotelevizionin e Prishtinës, tani me emrin e tij pagëzohen rrugë dhe magjistrale? Marrë në përgjithësi, shikuar nga kjo perspektivë, nga njëra anë, si askujt tjetër, na kërcënohet seriozisht një humbje e pakthyeshme e kujtesës kolektive; me anë tjetër shpesh themi me vete: duke qenë shoqëri që bënte jetë gjysmëpublike dhe gjysmëklandestine, duhet të jemi të lumtur që nuk i kemi dosjet!

### Përkthimi është ngatërruar keq

**Letërsia e huaj po vjen në shqipe shpejt, kryesisht nga botuesit e Shqipërisë, ndërkaq letërsia shqipe po depërton jashtë shumë pak. Është letërsi e varfër tematikisht dhe stilistikisht, apo çfarë po ndodh? Mund të na përmendi shkaqet?**

Letërsia shqipe, marrë në përgjithësi, duke marrë për bazë veprat e shkrimtarëve më të mirë, është letërsi cilësore. Unë lexoj mjaftueshëm sa për të bërë krahasime, vetëm se ka një problem: nga letërsia shqipe, pas Kadaresë, janë përkthyer vepra jocilësore, kështu që është krijuar përshtypja se pas këtij autori është një shkretëtirë. Këtë e kanë bërë përkthyesit pa shije letrare të letërsisë shqipe, të cilët kanë krijuar një imazh të keq për të. Po këta përkthyes, duke mos njohur mirë gjuhën shqipe dhe gjuhën në të cilën përkthejnë, kanë marrë për përkthim veprat e shkruara dobët, sepse ato përkthehen më lehtë, nga se gjuha e tyre është e thjeshtë, shpesh vulgare. Njohje vulgare të gjuhës shqipe kanë edhe shumica e atyre që sot pretendojnë të përkthejnë në ndonjë gjuhë tjetër. Ndërkaq, përkthimi në shqip nga gjuhët e tjera është ngatërruar keq: ka përkthime të mira, por ndodh të botohen edhe vepra që nuk e kanë as minimumin e vlerës. Në Kosovë kemi pasur një traditë përkthimi, ashtu siç ishte, por tani nuk ekziston më. Përkthyes të rinj në Kosovë nuk gjenden, sepse nuk ka më audiencë letrare dhe nuk ka botues që i mbështet.

### Nuk bëhet karriera letrare, as shkencore, duke bërë kujdestarin e gabimeve të të tjerëve

**Jeni anëtar i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës (AShAK) që shumë vjet. Para po dhe pas jush janë bërë anëtarë Akademie edhe disa studiues të tjerë, puna studimore dhe eseistike e të cilëve konsiderohet e dyshimtë, pasi disa kritikë dhe studiues kanë vënë re plagjiaturë në librat e tyre dhe i kanë publikuar në media. Çfarë mund të na thoni për këtë rast?**

Çështja e plagjiaturave nuk e prek vetëm Akademinë dhe jo vetëm Universitetin, por mbarë shkrimin shqip, që nga letërsia e deri te shkenca, titujt dhe hartimet shkencore të të gjitha fushave. Madje ky është bërë problem botëror. Është bërë problem edhe në mësimdhënie, edhe në edukim. Nëpër shtyllat dhe pemët përreth Universitetit ngjiten afishe në të cilat shkruhet: Bëjmë

→

# KULTUROR NUK NDALET

tema diplome dhe për master, dhe poshtë janë shkruar numrat e telefonave të atyre që i përgatitin. Kjo është njësoj sikur dikush të shkruante në një shpallje: Bëjmë prostitucion, dhe më poshtë ta shkruante numrin e telefonit. Pra, puna e shkencës te ne ka degraduar shumë. Përhapja e madhe e internetit ka bërë që qarkullimi i ideve të mos ndiqet më. Megjithatë, ekziston një minimum rregulli dhe morali edhe në këtë mes. Para tre-katër vjetësh, kur u bë ligji i ri për Akademinë dhe u nxorën aktet e tjera normative, unë kërkova që disa çështje ta marrin përgjigjen adekuate edhe me normat ligjore dhe statutare. Nuk u pranua. Tani puna e plagjiaturave është çështje e moralit publik të secilit anëtar veç e veç.

Me anë tjetër, dua të them se edhe ata që merren me punët e plagjiaturave duhet të jenë pak më seriozë dhe më të besueshëm: nuk bëhet karriera letrare, as shkencore, duke bërë kujdestarin e gabimeve ose të shkarjeve që bëjnë të tjerët, qofshin ata edhe akademikë; duhet të bësh edhe vetë një punë që ia vlen, që të kesh të drejtë morale t'ua nxish ymrin të tjerëve, duke ua mbajtur mbi kokë gabimet ose dështimet.

### Medice, cura te ipsum, thoshin romakët

**A keni mbajtur ndonjë mbledhje për ta diskutuar plagjiaturën në tekstet e tyre dhe a u është tërhequr vërejtja ndonjëherë atyre nga organi i AShAK-ut me ndonjë vendim ose a është marrë për ta masë disiplinore?**

Pyetjes do t'i përgjigjem me pyetje: ju në Bibliotekën Kombëtare a keni mbajtur ndonjë mbledhje në të cilën do të diskutonit publikisht për projektin e bibliografisë së librit shqip në Kosovë dhe ish-Jugosllavi, të cilën e ka hartuar Tahir Foniqi, ndërsa sekush përpiqet t'ia tjetërsojë autorësinë? Apo, a keni mbajtur mbledhje dhe a keni diskutuar publikisht zhbërjen e fondeve librare në Bibliotekë? Apo projektin e dështuar të Bibliotekës Universitare?

Medice, cura te ipsum, thoshin romakët.

### Në Akademi kanë hyrë njerëz që nuk e meritojnë të jenë aty

**Po, kemi mbajtur mbledhje, kemi diskutuar dhe, ka ndonjë punëtor si puna ime, për shembull, ose si djali i Tahir Foniqit e ndonjë tjetër që po pret ta përfundojë Biblioteka atë projekt dhe ta publikojë atë bibliografi dhe ne ta padisim institucionin dhe kryeredaktorin në gjykatë për shkelje të të drejtave të autorit. Por, derisa ta kryejë Biblioteka këtë projekt, le të diskutojmë pak edhe për akademikët e rinj. Kohën e fundit u bënë anëtarë Akademie edhe disa studiues të rinj nga fusha të ndryshme të artit dhe të shkencës. S'po kërkojmë të dimë nëse keni votuar për t'u bërë ata akademikë dhe nëse e kanë merituar bërjen akademikë, por dua të dimë kush do të duhej të bëhej para tyre, sipas jush?**

Për Akademinë unë jam më kritik se të gjithë ju që jeni kritikë për institucionet ku punoni. Ju e dini shumë mirë se kjo ka çmimin e vet, të cilin unë e paguaj në vazhdimësi. Po, është e vërtetë se në Akademi kanë hyrë njerëz që nuk e meritojnë të jenë aty, madje të tillët lavdërohen më shumë se ata që bëjnë një punë me vlerë. Por kjo është shoqëria jonë, e cila nuk di të vlerësojë, sepse vetë është e përfshirë në një sjellje rrethore jovlerash dhe vanitetesh. Së këndejmi, prurjet jocilësore në Akademi janë të lidhura ngushtësisht me punën e keqe të institucioneve shkencore dhe kulturore të Kosovës dhe nuk varen vetëm nga Akademia. Sido që të jetë, në dhjetë vjetët e fundit, me dy pranimet radhazi, punët kanë shkuar më keq se çdo herë tjetër. Brenda Akademisë janë formuar grupe interesi, klane, banda, quani si të doni, si në çdo institucion tjetër. Këto klane sundohen dhe manipulohen nga individë të caktuar. Ndonjëherë edhe ata nga jashtë që ngrenë zërin kundër Akademisë nuk synojnë gjë tjetër përveçse të futen brenda dhe ta marrin sundimin e saj. Pse, çfarë do të bënin tjetër, ta zëmë, ata të Institutit Albanologjik përveçse një klan do ta zëvendësonin me një klan tjetër. Por edhe në këtë sjellje rrethore primitivizmash do të duhej të kishte një minimum morali: nuk mund të bëhet anëtar Akademie dikush që ka botuar vetëm një libër dhe vetëm disertacionin para 30 vjetësh, pastaj në krah të tij vjen një manipulator tjetër nga fusha e shkencave shoqërore, pastaj dikush që nuk ka bërë asgjë në fushën e shkencës albanologjike, pastaj një tjetër nga fusha e shkencave të mjekësisë dhe një i katërt nga fusha e arteve. Dhe kështu, pak nga pak, ata fillojnë ta bëjnë shumicën dhe, natyrisht, mbrojnë interesat e njëri-tjetrit. Kjo situatë në Akademi është dëshpëruese edhe për një arsye tjetër: vendimet aty janë të pakorrigjueshme dhe të pakthyeshme.

### Fjalori Enciklopedik i Kosovës është vepra më e mirë kolektive

**"Fjalori enciklopedik i Kosovës", dyvëllimësh, me pamje të zezë dhe me shkronja ari, doli nga shtypi këtë vit. U tha çdo e zezë për të sapo doli në dritë. U tha dhe u shkrua se as nuk është fjalor, as nuk është enciklopedik; po se është "fjalor antikombëtar", "përçarës", "familjar", që fsheh historinë e re dhe të vjetër të Kosovës, që ka pasaktësi dhe të meta të shumta. Prej botimit të tij e deri më tash keni shkruar vetëm një shkrim në vend të arsyetimit. Pse u botua ai fjalor ashtu, me gjithë ato gabime?!**

E kam thënë edhe një herë tjetër, tani vetëm po e përsëris: Fjalori Enciklopedik i Kosovës është vepra më e mirë kolektive e botuar në gjuhën shqipe. Euforia e kritikave dhe insinuatave për Fjalorin Enciklopedik të Kosovës flet për një shoqëri dhe ambient kulturor që është mësuar të jetojë në iluzione për vlerat e veta dhe nuk pranon t'i bëhet një vlerësim institucional, aq më pak nga Akademia, të cilën sekush më parë se tjetri shpejton ta nxijë dhe ta damkosë. Ky është problemi i parë. E dyta ka të bëjë me gabimet reale, që mund të ketë një botim i këtillë, me 1 818 faqe të formatit të madh dhe me shkronja të vogla, me rreth 6 000 zëra, me 24 redaksi, me 72 anëtarë redaksish dhe me 506 autorë tekstesh.

Megjithatë, duhet të them menjëherë, se kualifikimi i Fjalorit si antikombëtar është më i shpifuri prej krejt kualifikimeve të tjera, sepse është etiketë, është damkë që mund t'i vihet kujtdo, pa pasur nevojë të argumentohet. Po pse me kaq ngutje iu vu kjo damkë Fjalorit Enciklopedik të Kosovës, nga ndonjë individ që prej kohësh e ka marrë përsipër punën e vështirë të presë bileta "kombëtare" ose "antikombëtare" për parajsë ose për ferr? Pse pa e shfletuar ende, pa parë përmbajtjen, pa gjetur tamam asnjë gabim? Sepse kualifikimet e këtilla bëhen pikërisht kështu, me zhurmë, me fjalë të mëdha, pa argumente. Megjithatë, siç mund të merret me mend, arsye për një faj të këtillë mund të jetë pse Fjalori Enciklopedik i Kosovës e paska ndarë Kosovën nga Shqipëria dhe pse ky botim nuk e paska lënë Fjalorin Enciklopedik Shqiptar ta ruajë monopolin e tij edhe në Kosovë. Lidhur me ndarjen e Kosovës si entitet më vete, në parathënie është shkruar: "Botimi i këtij Fjalori, përveç që përmbush nevojat për një shfrytëzim të gjerë nga lexues të ndryshëm, njëkohësisht krijon bazën e të dhënave për Kosovën si entitet i mëvetësishëm politik, gjeografik, ekonomik dhe kulturor, por duke mbajtur në vëmendje se Kosova është pjesë e një tërësie më të gjerë historike dhe kulturore shqiptare dhe se ndarjet në këtë drejtim, pavarësisht nëse janë të përkohshme ose të qëndrueshme, gjithnjë janë artificiale dhe të panatyrshme". Dhe më tej: "Përfshirja e ndarë e Kosovës në këtë lëndë enciklopedike nuk paragjykon qëndrueshmërinë e zgjidhjeve politike, as aktuale e as të pritshme. Ndarja e Kosovës nga tërësia historike dhe kulturore shqiptare në këtë rast është bërë për arsye praktike dhe, duke anashkaluar çdo interpretim me prapavijë, synon të konsolidojë dijet për botën shqiptare dhe ta plotësojë informacionin për të, kudo që ai mund të përfshihet dhe të përdoret". Çfarë sekreti antikombëtar paska këtu? Fjalori nuk e shpalli Kosovën shtet të pavarur dhe sovran, nuk ia bëri Kushtetutën, Parlamentin, Qeverinë, Flamurin, Himnin, kufijtë etj. Nuk vendosi ky fjalor që Kosova të mos bashkohet me Shqipërinë, sikundër që nuk do të vendosë nëse Kosova do të mbetet e tërë, apo do të ndahet sipas ideve "kombëtare" të rrënuesve të integritetit të saj. Atributet e këtilla "antikombëtare" për Fjalorin janë alibi për të mos u përballur me asnjë argument. Me anë tjetër, Fjalori Enciklopedik Shqiptar nuk i plotëson as kriteret minimale për të qenë edhe "i Kosovës", pra mbarëshqiptar, sepse në përfshirjen e zërave nga Kosova ka zbatuar kritere krejtësisht të paqëndrueshme dhe joprofesionale. Nga rreth 8 000 zëra sa ka Fjalori Enciklopedik Shqiptar, vetëm rreth 10 % i kushtohen Kosovës. Ja një shembull i trajtimit të pabarabartë të Kosovës: komunat janë njësitë më të vogla administrative që janë përfshirë në Fjalorin Enciklopedik Shqiptar, por komunat në Shqipëri dhe komunat në Kosovë nuk kanë asnjë mundësi krahasimi (komuna në Shqipëri është e barabartë me bashkësinë lokale në Kosovë). Sido që të jetë, Fjalori Enciklopedik i Kosovës nuk është bërë për t'iu kundërvënë as për ta mohuar Fjalorin Enciklopedik Shqiptar, por për ta plotësuar atë dhe për të qëndruar pranë tij. Po ashtu, duhet të them se të pakënaqur me Fjalorin janë disa prej anëtarëve të Akademisë sepse janë mësuar që biografitë e veta t'i prezantojnë në publik "pa redakturë", që domethënë me plot vetëmburrje dhe pasaktësi. Ndërkohë, në ditën e promovimit, në mbrëmje, KTV-ja nxori në ekranin e vet një përgojim të pashembullt: nga dy eksponentë të OJQ-ve u tha se Fjalori nuk vlente as dy grosh, ndonëse asnjëri, as moderatori i emisionit dhe as dy personat në studio, ende nuk e kishin parë me sy botimin. Pas këtij emisioni filloi "ndjekja e shtrigave": secili gazetar që nuk ishte i përfshirë në Fjalor (disa prej të cilëve e them me bindje se kurrë nuk do të bëhen gazetarë), ia filluan fushatës antikulturore për Fjalorin: Klan-Kosova, RTK-ja, KTV-ja, T7 etj. Pra, situata ishte e qartë: Unë kisha bërë një herezi të tmerrshme: kisha marrë guximin të mos i përfshija të gjithë gazetarët e të gjitha redaksive (mbi një mijë sish), e kjo do të thotë se kisha hyrë ne çerdhen e grerëzave i pambrojtur. Dhe kështu pasuan kronikat një pas një dhe deklaratat e të pakënaqurve. Por cilat janë gabimet reale të evidencuara deri tani në opinion:

1. Mungon Bajram Rexhepi (përgjegjëse redaksia e fushës politike-juridike: Blerim Reka, Osman Ismajli, Ilir Dugolli);
2. Viti i lindjes i gabuar për Ibrahim Rugovën (përgjegjës autori i tekstit: Blerim Reka);
3. Mungon Luljeta Pula-Beqiri (përgjegjëse redaksia e fushës politike-juridike);
4. Mungojnë gazetat "Bota e re", "Zëri i Kosovës" dhe "Epoka e re" (përgjegjëse redaksia e fushës së informimit: Ibrahim Berisha, Milazim Krasniqi, Rrahman Paçarizi);
5. Emri i gabuar i Rexhep Murtez Shalës në legjendën e fotografisë (përgjegjës autori i tekstit: Agron Gashi);
6. Datë e gabuar në tekstin për Frang Bardhin, në vend 1743 duhet 1643 (përgjegjës autori i tekstit: Rexhep Ismajli);
7. Biografia me të dhëna të gabuara e Jakup Cerajës (përgjegjës autori i tekstit: Kujtim Rrahmani);
8. Fshati Vërban i komunës së Vitisë duhet të jetë Vërboc i komunës së Kllokotit (përgjegjës kryeredaktori, pra unë, sepse kam pranuar ndërhyrjen e lektorit të fundit të tekstit, Shefqet Rizës).

Këto janë tetë "zbulimet e mëdha" të gabimeve në Fjalorin Enciklopedik të Kosovës! Besoj dhe është krejt e natyrshme të ketë edhe më shumë, por kaq gabime të pranueshme janë evidencuar deri tani. Nuk konsiderohen gabime dhe nuk do të merren në konsideratë as nga kryeredaktori dhe as nga Redaksia Qendrore mospërfshirja e disa aktivistëve të LDK-së, të cilët pretendohet se janë bërë heronj vetëm për shkak të aktit kriminal të vrasjes së tyre. Ndërkaq, pretendimet janë nga më të ndryshmet, jo vetëm të pambështetura, por edhe joserioze, kështu që një numër syresh as nuk ia vlen të shqyrtohen e të diskutohen.

### Më mungojnë Ali Podrimja dhe Basri Çapriqi

**Sigurisht ende i ruani në celular ose në notes numrat e celularëve të miqve që tashmë kanë ndërruar jetë. Kush prej tyre ju mungon më së shumti?**

Po, dy syresh më mungojnë shumë: Ali Podrimja dhe Basri Çapriqi. Numrat e tyre të telefonit ende i kam në celularin tim.

### Prishtina në romanin "Prishtina" është qytet metaforë

**Para disa ditësh botuat romanin "Prishtina". Një fragment të tij, goxha të gjatë, e kam lexuar në numrin e dytë të këtij reviste për të cilën po realizojmë intervistën. Pa dyshim, ky roman ka materiale të mira për t'u bërë disa filma të shkurtër për luftën dhe pasluftën, edhe një film të gjatë me disa sekuenca të luftës së Kosovës. Sikur thotë edhe titulli, ngjarjet e tij ndodhin në Prishtinë. Po sa janë reale ngjarjet e "Prishtinës"?**

Romani doli në Panairin e Librit në Tiranë, është nëpër librari, në duart e ndonjë lexuesi dhe tani le ta vlerësojë secili sipas shijes së vet. Sa iu përket filmave të gjatë apo të shkurtër, nuk është një gjë që më intereson në mënyrë specifike, sikundër që nuk ka shumë rëndësi nëse ngjarjet e përfshira në këtë rrëfim janë reale apo të imagjinuara. Si në të gjitha rrëfimet letrare, si në çdo vepër letrare që nga antika e deri më sot, ato janë të mundshme dhe të besueshme, pra kanë besueshmëri artistike. Ky është çelësi i rrëfimit në çdo roman, në çdo dramë, në çdo film, në të gjitha artet narrative. Zhvillimet në romanin "Prishtina" mund të kenë më shumë ngjashmëri me atë që kemi përjetuar të gjithë ne menjëherë pas vitit 1999, me t'u kthyer në Prishtinën e çliruar nga trupat e NATO-s. Por, duke qenë shkrimtar dhe duke qenë i pajisur me një imagjinatë krijuese, rrëfimi im në romanin "Prishtina" shkon një hap më tej nga ajo që kanë mundur të përjetojnë njerëzit në një rrethanë të këtillë: përveç që ka përshkrime ndoshta të ndiera, ku mund të hyjnë edhe situata reale dhe njerëz realë, ka më shumë se në çdo vepër timen ndjenjë dhe mendim. Me anë tjetër, Prishtina në këtë roman është qytet metaforë, kurse unë në asnjë rrethanë nuk bëj deshifrimin e metaforave, as në librat e mi, as në librat e të tjerëve. E kam ves që nga koha e komunizmit, kur deshifrimi i metaforave mund të ishte shumë i papëlqyeshëm!

**Intervistoi: Berat Armagedoni**

*(Intervista është marrë nga numri i katërt i revistës për kulturë, gjuhë dhe media, "Akademia". Numrat e mëparshëm të kësaj interviste, pos në revistë, mund t'i lexoni në tre numrat pararendës të gazetës "Epoka e re". Fund)*




Sport

QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

| PROGNOZA SPORTIVE | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | MAN CITY - BURTON ALBION | 5+ | VILLARREAL - ESPANYOL | 1 | GETAFE - VALLADOLID | 3+ |

# Selimi: Duhet të besojmë në trajnerët vendorë



Musa Selimi ka thënë për "Epokën e re" se ardhjet e shumë trajnerëve në Kosovës e kanë pasuruar futbollin, por ai ka thënë se duhet t'u besohet më shumë trajnerëve vendorë. "Normalisht se e kanë pasuruar dhe e kanë shtuar konkurrencën në futbollin e Kosovës, por jam ithtar i asaj që t'u besohet më shumë trajnerëve dhe futbollistëve vendorë", ka thënë Selimi

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

**Prishtinë, 8 janar** - Trajnerët jashtë Kosovës po e "vërshojnë" çdo ditë e më shumë IPKO Superligën e Kosovës në futboll. Aktualisht pesë skuadra elitare drejtohen nga trajnerët që vijnë nga Shqipëria, Maqedonia dhe Italia. Ndërsa skuadra e gjashtë, Gjilani, drejtohet nga trajneri që është nga Lugina e Preshevës, Sadat Pajaziti. Trajneri i njohur dhe njohësi i mirë në sportin e Kosovës, Musa Selimi, ka thënë se ardhjet e këtyre trajnerëve e pasurojnë futbollin por, sipas tij, klubet duhet më shumë t'u besojnë trajnerëve dhe futbollistëve vendës. "Normalisht se e kanë pasuruar dhe e kanë shtuar konkurrencën në futbollin e Kosovës, por jam ithtar i asaj që t'u besohet më shumë trajnerëve dhe futbollistëve vendorë", ka thënë Selimi "për "Epokën e re", që me sukses në të kaluarën ka drejtuar disa skuadra të futbollit.

Musa Selimi, që është edhe dekan në Fakultetin e Kulturës Fizike dhe Sportit, ka folur edhe për garën për titullin të kampiones në elitën e futbollit. Ai ka veçuar tri skuadrat e para si favorite, kurse për Kupë i sheh favorite vetëm Prishtinën dhe Feronikelin. "Për titull deri në fund do të luftojnë Prishtina, Feronikeli dhe Llapi, ani pse kjo skuadër është pak mbrapa me pikë karshi dy skuadrave të para. Ndërsa për Kupë favorite janë Prishtina dhe Feronikeli. Edhe në pranverë do të kemi një sezon shumë interesant në futboll", ka deklaruar ai.

Musa Selimi në të kaluarën i ka drejtuar Dritën, Feronikelin, Gjilanin, KEK-un dhe Ramiz Sadikun, kurse ofertat për këtë trajner nuk kanë munguar asnjëherë, por angazhimet e tij në fakultetet dhe në Federatën e Sporteve Universitare të Kosovës kanë bërë që "Profa" t'u thotë jo këtyre ofertave.

## SHKURT

### Hyseni zyrtarizon largimin nga Gjilani

Ergon Hyseni me anë të një postimi në "Facebook" ka bërë me dije se është larguar nga skuadra e Gjilanit. "Një falënderim për të gjithë 'Skifterat' me të cilët ndamë shumë gëzime e hidhërime, adrenalinë e ndjenja të llojllojshme në çfarëdo rasti ku më bënë të ndihem si në shtëpi", ka shkruar Hyseni, i cili kohën sa ishte në klubin e Gjilanit e cilëson më të mirën në jetën e tij.

### Zeneli mund t'i bashkohet Galatasarayt

Arbër Zeneli duket se ka vendosur rreth së ardhmes së vet. Ai pritet të largohet nga Heerenveeni, duke u transferuar te Galatasaray. Lojtari i Përfaqësueses së Kosovës po largohet nga skuadra holandeze pasi nuk mund t'i mbulojnë shpenzimet e veta. Zeneli ka kërkuar pagë më të lartë, andaj Heerenveeni nuk mund ta përballojë kërkesën e tij. Mesfushori kosovar është në bisedime me Galatasarayn, e marrëveshja është shumë afër të arrihet.

### KF Gjakova rikthen edhe Hadrin

KF Gjakova, pasi riktheu katër futbollistët Leonard Ndreca, Dafnis Brahimaj, Shpat Tabaku dhe Mevlan Mullakadrija, është përforcuar edhe me sulmuesin Urim Hadri. Hadri ishte pjesë e KF Gjakova edhe në të kaluarën, kurse ka luajtur edhe për KF Rilindja dhe KF Dardanët.

### Mehmedi mund ta përfundojë karrierën te Wolfsburgu

Sulmuesi Admir Mehmedi mund të qëndrojë gjatë te skuadra gjermane Wolfsburg. Ai në një intervistë të gjatë dhënë gazetës gjermane "Bild" ka theksuar se është i kënaqur te Wolfsburgu. "Momentet që po i kaloj këtu në Wolfsburg do t'i ëndërronte çdo futbollist. Këtu kam gjithçka. Për mua si një njeri familjar, qyteti është i përsosur. Mund të qëndroj në Wolfsburg dhe më vonë të punoj edhe me të rinjtë e këtij klubi. Zvicra nuk është opsion për vazhdimin e karrierës. Në fund të karrierës, Amerika do të ishte opsion ideal. Por ka mundësi ta përfundoj karrierën në Wolfsburg", ka thënë Mehmedi. "Dua të vazhdoj me këtë ritëm. Deri tash ia kam dal. Unë kam potencial të jem edhe më efektiv dhe të shënoj më shumë gola. Kam përmirësuar shumë gjëra gjatë këtij edicioni dhe po më përshtatet roli i lojtarit të lirë në fushë", është shprehur Mehmedi.

